



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE  
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO  
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND



# 2021 RAPORTI VJETOR



FONDY KOSOVAR PER GARANCI  
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO  
KOSOVO CREDIT GUARANTEE



# PËRMBAJTJA

## **04 PJESA I - INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME**

- 06 Fjala e Kryetarit të Bordit dhe e Drejtorit Menaxhues
  - 10 Akronimet
  - 11 Përmbledhje e treguesve financiarë
- 

## **12 PJESA II - PROFILI I INSTITUCIONIT**

- 14 Themelimi i FKGK-së dhe statusi i saj
  - 14 Misioni
  - 15 Vlerat institucionale
  - 16 Skemat garantuese
- 

## **18 PJESA III - QEVERISJA KORPORATIVE**

- 20 Bordi i Drejtorëve dhe personeli
  - 22 Struktura organizative
  - 23 Komitetet
    - 23 Komiteti i Menaxhimit të Riskut
    - 23 Komiteti i Auditimit
  - 24 Bashkëpunëtorët e FKGK-së
  - 25 Takimet e Bordit të Drejtorëve dhe të komiteteve përkatëse
- 

## **26 PJESA IV - PERFORMANCA E FKGK-së**

- 28 Zhvillimi i portofolit të garancive
  - 32 Dritarja Agro - zhvillimi/risitë garantimi i Agro financimit përmes Dritares Agro
  - 34 Shtueshmëria
  - 39 Menaxhimi i riskut kreditor
  - 43 Sistemit të menaxhimit mjedisor dhe social
  - 44 Veçoria e vitit 2021
- 

## **46 PJESA V - AKTIVITETET GJATË VITIT 2021**

- 48 Aktivitetet gjatë vitit 2021
  - 58 FKGK në media
  - 59 Storie suksesi
- 

## **62 PJESA VI - PASQYRAT FINANCIARE TË AUDITUARA**

# PJESA I



# INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

# FJALA E KRYETARIT TË BORDIT DHE E DREJTORIT MENAXHUES

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (tutje FKGK-ja) edhe gjatë vitit 2021 tregoi që është një institucion i rëndësishëm për ekonominë e vendit, duke ndihmuar në rritjen e qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, (tutje NMVM-të).

Implementimi me sukses i dritareve garantuese në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike u tregua si një ndër masat më të nevojshme në kuadër të programit të përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës në luftimin e ndikimit negativ të pandemisë COVID-19.

Dinamika e shtuar në shfrytëzimin e limiteve të garancive kreditore në FKGK-ja, përgjatë tërë vitit, është treguesi më i mirë që dritaret e garancive brenda PRE-së, kanë qenë instrument i rëndësishëm kundër-ciklik për t'i luftuar ndikimet negative nga pandemia COVID-19. Për më shumë, kjo rritje vjen pikërisht nga dritaret në kuadër të pakos së rimëkëmbjes ekonomike, të dizajnuara enkas për të mbështetur sektorët ekonomikë që kanë pësuar më së shumti nga kriza e pandemisë, si dhe të konsideruar si strategjike për përmirësimin e strukturës ekonomike të vendit tonë.

Disejnim i adekuat i dritareve garantuese nëkuadër të PRE-së, adresimi me kujdes i nevojave të segmenteve të caktuara të tregut, si dhe rritja e përqindjes së mbulueshmërisë në 80%, u treguan faktorë me rëndësi në rikthimin e besueshmërisë në treg, rritjen e kreditimit për NMVM-të, e që më pastaj ndikoi drejtpërdrejtë në përmirësimin e likuiditetit dhe rinisjen e investimeve private në ekonomi.

Përkundër vazhdimit të situatës epidemike edhe këtë vit, personeli i FKGK-së arriti me sukses t'i përgjigjet nevojave të institucionit, duke e përshtatur skemën garantuese me situatën e re të krijuar në treg, për t'i tejkaluar sa më lehtë pasojat e krizës nga pandemia. Ishte një motiv që burimin e kishte në një energji të brendshme, diçka që tejkalon objektivat personale dhe afatshkurta, me qëllim që të kontribuohet në një kauzë më madhore, që vendi ynë të dalë edhe më i fortë nga një krizë e tillë. Për këtë, e falënderojmë secilin nga ta, duke besuar që sukcesi i institucionit, mbi të gjitha, është rezultat i punës së palodhshme, të përkushtimit dhe profesionalizmit të tyre.





Zhvillimi pozitiv i institucionit tonë dhe ndikimi që ky zhvillim ka pasur në ekonominë reale mund të shihet në të gjithë treguesit kryesorë që portretizojnë shtueshmërinë financiare dhe ekonomike. Me 3,961 kredi të garantuara gjatë vitit 2021, kanë përfituar 3,315 ndërmarrje private. Si rezultat, portofolio e garancioneve kreditore shënoi rritje të theksuar gjatë vitit 2021 prej 120%, duke arritur vlerën prej 126 milion Eurove. Me një pjesëmarrje prej 8% të vlerës aktive të garancive aktive në raport me Bruto Prodhimin Kombëtar, si indikator që tregon intensitetin e ndërmjetësimit financiar nga skemat garantuese, Kosova renditet më së miri nga të gjitha vendet e rajonit, me ç'rast vlera e këtij indikatori në nivel rajonal nuk kalon 1.8%. FKGK qëndron më mirë se rajoni edhe me indikatorin që tregon pjesëmarrjen e ndërmarrjeve aktive që kanë përfituar nga skema garantuese e FKGK-së në raport me të gjitha ndërmarrjet aktive në mbarë vendin. Me 14.6% sipas AECM, Kosova edhe me këtë indikator tregon që instrumenti i skemës së garancioneve ka gjetur përdorim të theksuar në vendin tonë, dukshëm më mire se sa në vendet fqinje.

Në ndërkohë që pjesëmarrja e klientëve të rinj që për herë të parë kanë krijuar relacione kreditore me banka arriti në 25%, pjesëmarrja e kredive të garantuara nga FKGK për biznese të reja pa relacione të mëhershëm kreditore arriti në 33%. Që do të thotë që çdo i treti klient i garantuar nga FKGK ishte klient i ri kreditor, të cilit në saje të garancive kreditore nga FKGK iu mundësua të krijojë histori

kreditore me një institucion financiar. Kërkesa për kolateral, si një nga barrierat kryesore në kreditimin e NMVM-ve, qoftë për klientët e rinj apo edhe për ata ekzistues, është ulur ndjeshëm për kreditë e garantuara krahasuar me kreditë e pagarantuara. Vetëm gjatë vitit të kaluar kemi vërejtur që një përqindje e theksuar e klientëve të kredituar kanë qenë të kolateralizuar me më pak se 100% të vlerës së kredisë, derisa 31% apo 554 klientë janë kredituar pa pasur nevojë të plasojnë kolateral fare.

Qasja aktive e institucionit në ndërtimin e dritareve adekuate për t'i trajtuar nevojat specifike të ndërmarrjeve në sektorin e bujqësisë, prodhimtarisë dhe gratë ne biznes, konsideruar si sektorë të rëndësishëm për ekonominë kombëtare, ka rezultuar me përfaqësim dukshëm më të lartë të këtyre sektorëve në portofolin tonë, krahasuar me pjesëmarrjen e tyre në nivel të portofolit kreditor në sektorin bankar. Si rezultat, sektori i prodhimit është i përfaqësuar në portofolin tonë me 24%, ndërsa sektori i bujqësisë me 9.7%

Po ashtu, dritarja e destinuar për fuqizimin e grave në biznes në portofolin tonë gjatë vitit 2021 kishte një përfaqësim prej 14%, pjesëmarrje më e lartë krahasuar me gjithsej kredidhënien në sektorin bankar për këtë segment.

Viti i kaluar shënoi edhe fillimin e bashkëpunimit me institucionet mikrofinanciare. Me këtë realizuam edhe një objektiv tjetër, që është mbulimi i të gjithë segmenteve të tregut, duke


përfshirë tani edhe segmentin e ndërmarrjeve mikro. Me këtë partneritet të ri, portofoli ynë i institucioneve partnere financiare është populluar me shtatë banka komerciale, katër institucione mikrofinanciare dhe një institucion financiar jo bankar që ofron shërbime leasing. Kjo përforcon edhe më tej qasjen gjithëpërfshirëse të institucionit tonë, diçka që ka qenë qëllim institucional që nga ditët e para të themelimit.

I gjithë ky aktivitet në shfrytëzimin e garancive kreditore në FKGK është mbështetur nga një bazë e kapitalit me vlerë prej 55.4 milion Eurove. Mbështetja nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe donatorët tanë ndërkombëtarë, kryesisht nga USAID dhe KfW, në kapitalizimin e institucionit nuk mungoi as gjatë kësaj periudhe. Posaçërisht, vlen të përmendet vazhdimi i kontributit nga KfW, në vlerë prej 6.0 milion Eurove, i destinuar për garantimin e kredive të gjelbra që rrisin eficiencën në shfrytëzimin e energjisë dhe prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme.

FKGK vazhdon të mbetet njëri nga depozitorët më të mëdhenj në sektorin bankar në Kosovë. Për të pestin vit me radhë, strategjia e investimeve e FKGK-së, në masën më të madhe, është e orientuar në formë të depozitave afatshkurtra dhe afatmesme në bankat vendore. Kjo qasje institucionale pasqyron besimin e strukturave qeverisëse të FKGK-së në sektorin bankar të vendit tonë dhe, njëherazi, duke rritur likuiditetin në treg, ofron më shumë mundësi për ta rritur kapacitetin kreditues të bankave vendore.

Nga historia kemi mësuar që ekonomia, si aktivitet, në fillet e para të saj ka lindur si nevojë për të sjellë ndryshim në mënyrën e realizimit të nevojave gjithnjë në rritje, ndikuar nga modernizimi i shoqërisë, me resurse të limituara në natyrë. Ky parim na përcjell edhe ne në FKGK, edhe pas gjashtë viteve të operimit, me ç'rast kontributi në krijimin e një mendësie më ndryshe në mënyrën e të bërit biznes që do të sillte ndryshim, qoftë edhe marginal, në jetën ekonomike dhe në përgjithësi në shoqëri, mbetet qëllim i ekzistencës së institucionit tonë.

Sot, kur jemi dëshmitarë të degradimit sistematik të ambientit ku jetojmë, kushteve jo të mira të punës për punëtorë, është e domosdoshme që ne si institucion që ndihmon ndërmjetësimin financiar, të kemi kriteret të qarta në përzgjedhjen dhe mbështetjen e atyre investimeve të cilat, përveç rritjes ekonomike, janë edhe miqësore për ambientin dhe respektojnë dinjitetin e punëtorit. Ne besojmë që një bashkëveprimi i balancuar midis njeriut dhe natyrës mund të sjellë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe bashkëjetesë në relacionin njeri-natyrë edhe për gjeneratat e ardhshme. Sot, në FKGK presim të njëjtën qasje edhe nga partnerët tanë financiar, që investimet e mbështetura nga kreditimi i tyre jo vetëm mos të dëmtojnë por edhe të kenë ndikim pozitiv në përmirësimin e ambientit që na rrethon.







Për të arritur këtë balancë mjedisore, për të dytin vit me radhë FKGK punon sipas standardeve ndërkombëtare për menaxhimin e Riskut Mjedisor dhe Shoqëror, si dhe parakusht është që çdo institucion financiar për tu kualifikuar si partner i FKGK duhet t'i ketë zbatuar dhe praktikuar këto standarde.

Ndonëse kemi lënë prapa vite te suksesshme, duke punuar drejt konsolidimit të institucionit, sjelljes së ndryshimit në sektorin privat përmes mbështetjes së vazhdueshme të rritjes së qasjes në financa për MVME-të, si dhe së fundi drejt mbështetjes së rimëkëmbjes ekonomike nga kriza e pandemisë, para vetes kemi plane po aq ambicioze sa edhe në të kaluarën. Pozicionimi apo adaptimi i institucionit sipas dinamikave dhe nevojave të sektorit privat gjithnjë në rritje, arritja e ndikimit pozitiv në ekonomi dhe shoqëri, si dhe përgatitja e institucionit për të ndihmuar ekonominë e vendit tonë qoftë në rrethana normale apo edhe në rast të situatave të paparashikuara, do të mbetet mision në vetvete, ende i papërbushur për institucionin tonë. Rritja e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve tona në tregun lokal e veçanërisht në

tregun ndërkombëtar, që më pas do të rezultonte me rritjen e eksporteve, rritjen e investimeve që përveç që rrisin efikasitet në alokim të resurseve brenda ndërmarrjes mirëpo edhe janë mike për natyrën, ofrimi i mundësisë për sukses ideve të reja ndërmarrëse, janë thellë të inkorporuar në misionin tonë, ashtu si mund të jenë pjesë e orientimit të gjithmbarshëm ekonomik të vendit tonë.

Për fund, na lejoni që në emër të Bordit të Drejtorëve dhe stafit të FKGK-së t'i falënderojmë donatorët tanë ndërkombëtarë dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës për mbështetjen e vazhdueshme dhënë FKGK-së. I falënderojmë edhe të gjithë bashkëpunëtorët e tjerë, para së gjithash Bankën Qendrore të Kosovës (BQK-në) dhe institucionet financiare partnere, për bashkëpunimin e vazhdueshëm. Në të njëjtën kohë, në FKGK premtojmë që do të vazhdojmë të japim tërë potencialin tonë në funksion të përmbushjes së misionit tonë, me të qëllim që ndërmarrësia kosovare të arrijë sukses si në tregun vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

## **RINOR GJONBALAJ**

Kryetar i Bordit

## **BESNIK BERISHA**

Drejtor Menaxhues

# AKRONIMET

<b>ASK</b>		Agjencia e Statistikave të Kosovës
<b>BD</b>		Bordi i Drejtorëve
<b>BQK</b>		Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
<b>FKGK</b>		Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
<b>EIB</b>		Banka Evropiane për Investime
<b>EIF</b>		Fondi Evropian për Investim
<b>IF</b>		Institucioni Financiar
<b>IFJB</b>		Institucionet Financiare Jobankare
<b>IPF</b>		Institucionet Partnere Financiare
<b>IRF</b>		Institucionet e Regjistruara Financiare
<b>IFRS</b>		Standardi Ndërkombëtar për Raportim Financiar
<b>IMF</b>		Institucionet Mikrofinanciare
<b>KFW</b>		Banka Zhvillimore Gjermane
<b>KJP</b>		Kreditë Joperformuese
<b>KMR</b>		Komiteti për Menaxhim të Riskut
<b>KA</b>		Komiteti i Auditimit
<b>MF</b>		Ministria e Financave
<b>MFK</b>		Fondacioni i Mileniumit të Kosovës
<b>MCC</b>		Korporata e Sfidave të Mileniumit
<b>MTI</b>		Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë
<b>NMVM</b>		Ndërmarrje Mikro, të Vogla dhe të Mesme
<b>QRK</b>		Qeveria e Republikës së Kosovës
<b>PFSF</b>		Projekti për Fuqizimin e Sektorit Financiar
<b>PMMS</b>		Politika e Menaxhimit Mjedisor dhe Social
<b>PRE</b>		Pako e Rimëkëmbjes Ekonomike
<b>SIDA</b>		Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
<b>SMMS</b>		Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Social
<b>SHBK</b>		Shoqata e Bankave të Kosovës
<b>USAID</b>		Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar

# PËRMBLEDHJE E TREGUESVE FINANCIARË

TREGUESIT KRYESORË FINANCIARË	DHJETOR 2020	DHJETOR 2021
<b>KAPITALI</b>	<b>49,747,447</b>	<b>54,917,245</b>
Potenciali garantues	<b>182,897,947</b>	<b>214,178,534</b>
Limitet e alokuara	<b>83,350,000</b>	<b>172,750,000</b>
Shkalla e shfrytëzimit të limiteve nga IRF-të partnere	<b>67.1%</b>	<b>72.2%</b>
<b>BILANCI I GARANCIVE</b>	<b>55,997,787</b>	<b>126,092,114</b>
Nr. i kredive aktive të garantuara	<b>4,268</b>	<b>6,729</b>
Nr. i IRF-ve partnere	<b>8</b>	<b>11</b>
Mesatarja e garancive	<b>18,151</b>	<b>22,043</b>
Mesatarja e maturitetit	<b>36</b>	<b>37</b>
KJP (në %)	<b>1.55%</b>	<b>1.55%a 1.25%</b>
Mbulueshmëria e KJP-së me provizionim (në %)	<b>166%</b>	<b>210.4%</b>
<b>KAPITALI I INVESTUAR</b>	<b>23,778,921</b>	<b>51,646,646</b>

Vlerat monetare janë në euro



# PJESA II





# PROFILI I INSTITUCIONIT



## THEMELIMI I FKGK-SË DHE STATUSI I SAJ

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është institucion i pavarur dhe i qëndrueshëm, i cili u lëshon garanci institucioneve financiare për të mbuluar rrezikun për kreditë e NMVM-ve. FKGK-ja është themeluar në janar të vitit 2016, duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Ligji themelues i FKGK-së është sponsorizuar nga MTI-ja, me përkrahje të USAID-it përmes programit "Fuqizimi i mbështetjes kreditore" dhe Bankës Zhvillimore Gjermane (KfW). Ligji për FKGK-në ka hyrë në fuqi më 23 janar 2016.

## MISIONI

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është entitet juridik i pavarur me karakter zhvillimor, i cili ofron garanci kreditore për NMVM-të, duke ndarë riskun kreditor me institucionet e regjistruara financiare. Përmes garantimit të portofolit kreditor të institucioneve financiare ne synojmë rritjen e qasjes në financa për NMVM-të, mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrësisë, mbështetjen e prodhimit vendor dhe të atyre shërbimeve, të cilat krijojnë vlerë të shtuar, krijimin e vendeve të reja të punës dhe mbështetjen e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik.

Ne jemi të përkushtuar ndaj menaxhimit të qëndrueshëm korporativ dhe ndaj përgjegjësisë sociale që vjen me të. Duke i koordinuar aktivitetet me partnerët tanë: donatorët, institucionet financiare dhe rregullatorët lokalë mundohemi t'u shërbejmë interesave afatgjata ekonomike të vendit, komunitetit të biznesit dhe shoqërisë sonë në përgjithësi.

# VLERAT INSTITUCIONALE

Vlerat institucionale të FKGG-së, të cilat frymojnë brenda institucionit, si dhe shërbejnë për ndërtimin e praktikave të përditshme në punë sigurojnë udhërrëfim që aktivitetet tona afariste do të kenë një nivel të lartë të përgjegjshmërisë dhe do të jenë në përputhje me standardet më të larta etike dhe morale.

## TRANSPARENCA

Duke qenë institucion në interes publik, FKGG konsideron si shumë të rëndësishëm shpalosjen e informacionit lidhur me praktikën e punës, politikën dhe rezultatet financiare e operative me partnerët, me palët e tjera të interesit, si dhe me publikun e gjerë.

## PARTNERITETI DHE BASHKËPUNIMI

Ndërtimi i marrëdhënieve të shëndosha, duke u bazuar në transparencë dhe në përgjegjshmëri me partnerët tanë, ndihmon në arritjen e objektivave të përbashkëta, në ndërtim të besueshmërisë dhe respekt të ndërsjellë.

## OBJEKTIVITETI DHE PAVARËSIA NË VENDIMMARRJE

FKGG ruan objektivitetin dhe pavarësinë në vendimmarrje, duke u bazuar në arsye dhe në parime të shëndosha, duke nxitur zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit financiar.

## PËRKUSHTIMI

Punonjësit e FKGG-së me përkushtim dhe me profesionalizëm mundohen të realizojnë misionin dhe objektivat e saj, duke besuar në rolin dhe në ndikimin pozitiv, që institucioni do ta ketë në zhvillimin e shëndoshë ekonomik.

## PUNA EKIPORE DHE PROFESIONALIZIMI NË PUNË

FKGG-ja ka një ekip ekspertësh, të cilët bashkëpunojnë mbi bazat e respektit të ndërsjellë. Puna ekipore për zgjidhjen e problemeve dhe të iniciativave, komunikimi i hapur dhe ndarja e përvojave profesionale në mes vete janë bazamenti i suksesit të FKGG-së.

Integriteti dhe dinjiteti personal janë vlera që e përcjellin secilin punëtor në vazhden e realizimit të detyrave dhe të iniciativave në punë, pa bërë asnjë kompromis në këto parime.



# SKEMAT GARANTUESE

AECM është Asociacioni Europian i Institucioneve Garantuese, gjithsej numëron 48 anëtarë që operojnë në 31 vende të ndryshme të Europës.

Që nga viti 2018, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) përfaqëson Kosovën brenda familjes së AECM-së.

Anëtarët e AECM-së janë të përfshirë në hartën e ilustruar :



 **OUR 3 PARTNERS**

**REGAR**  
**SME FINANCE FORUM**  
**EMGN**

**OUR 48 MEMBERS**

 <b>AUSTRIA</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• aws</li><li>• NÖBEG</li></ul>	 <b>ESTONIA</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• KredEx</li></ul>	 <b>KOSOVO</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Kosovo Credit Guarantee Fund</li></ul>	 <b>RUSSIA</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• FSECA</li></ul>
 <b>AZERBAIJAN</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Azerbaijan Mortgage and Credit Guarantee Fund</li></ul>	 <b>FINLAND</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Finvera</li></ul>	 <b>LATVIA</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• ALTUM</li></ul>	 <b>SERBIA</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Guarantee Fund of the Autonomous Province of Vojvodina</li></ul>
 <b>BELGIUM</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Fonds Bruxellois de Garantie - Brussels Waarborgfonds</li><li>• PMV/z Waarborgen</li><li>• SOWALFIN</li></ul>	 <b>FRANCE</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Bpifrance</li><li>• Européenne de Cautionnement</li><li>• SIAGI</li><li>• SOCAMA</li></ul>	 <b>LITHUANIA</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Garfondas</li><li>• INVEGA</li></ul>	 <b>SLOVENIA</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Slovene Enterprise Fund</li><li>• Slovenian Regional Development Fund</li></ul>
 <b>BOSNIA AND HERZEGOVINA</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Guarantee Fund of the Republic of Srpska</li></ul>	 <b>GERMANY</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Verband Deutscher Bürgschaftsbanken</li></ul>	 <b>LUXEMBOURG</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Mutualité de Cautionnement</li><li>• Mutualité des p.m.e.</li></ul>	 <b>SPAIN</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• CESGAR</li></ul>
 <b>BULGARIA</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Municipal Guarantee Fund for SMEs of Sofia</li><li>• National Guarantee Fund</li></ul>	 <b>GREECE</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• HDB</li><li>• TMEDE</li></ul>	 <b>NETHERLANDS</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• RVO</li></ul>	 <b>SWITZERLAND</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Network of Swiss Guarantee Institutions</li></ul>
 <b>CROATIA</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• HAMAG-BICRO</li></ul>	 <b>HUNGARY</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• AVHGA</li><li>• Garantiqa</li><li>• MVA</li></ul>	 <b>MALTA</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• MDB</li></ul>	 <b>TURKEY</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• KGF</li><li>• TESKOMB</li></ul>
 <b>CZECHIA</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• NRB</li></ul>	 <b>IRELAND</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• SBCI</li></ul>	 <b>POLAND</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• BGK</li></ul>	 <b>UNITED KINGDOM</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• British Business Bank</li></ul>
	 <b>ITALY</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Assoconfici</li><li>• ISMEA</li></ul>	 <b>PORTUGAL</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• BPF</li></ul>	
		 <b>ROMANIA</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• FGCR</li><li>• FNGCIMM</li><li>• FRC</li></ul>	



AECM me bazë në Bruksel, u themelua në vitin 1992 me tre objektiva kyçe, në vijim:

1. Përfaqësim politik i anëtarëve të saj në institucione të BE-së, Grupit EIB, OECD etj.
2. Organizimi i shkëmbimit të praktikave më të mira ndërmjet anëtarëve të AECM
3. Promovimi i instrumentit të garancisë

Anëtarët e AECM-së janë ose skema të garancive të sektorit privat ose institucione publike promovuese ose banka. Misioni i tyre është të mbështesin NMVM-të në qasje më të lehtë në financa, d.m.th. ofrojnë garanci për NMVM-të që posedojnë një projekt ekonomisht të shëndoshë, por që nuk disponojnë kolateral të mjaftueshëm bankar. I ashtuquajtur i boshllëk i financimit i NMVM-ve që e zgjidhin institucionet garantuese, njihet si dështim i tregut. Duke garantuar për këto ndërmarrje, institucionet e garancisë ndihmojnë në adresimin e këtij dështimi të tregut dhe lehtësojnë qasjen në financa për NMVM-të.

Ndikimi më i gjerë social dhe ekonomik i këtij aktiviteti përfshin:

- Krijimi i vendeve të reja të punës dhe ruajtja e tyre nga skemat garantuese
- Inovacion dhe konkurrencë: grumbullimi i ideve të reja që çojnë në krijimin e konkurrueshmërisë së shëndoshë për të gjithë pjesëmarrësit në treg
- Strukturë dhe diversifikim në ekonomitë Europiane
- Zhvillim regional përmes përkrahjes së projekteve të shumta rurale
- RolCounter-rol i gjatë krizave

Institucionet garantuese operojnë me ri-garancione në nivelin regjional, nacional dhe European. Deri në fund të vitit 2021 anëtarët e AECM-së arritën volum të portofolit garantues në: 312 miliard euro.





# PJESA III





**QEVERISJA  
KORPORATIVE**



# BORDI I DREJTORËVE DHE PERSONELI

FKGK qeveriset nga një Bord i Drejtorëve i përbërë nga shtatë (7) anëtarë:

- A. Një (1) anëtar sipas detyrës zyrtare, i emëruar nga Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë e Republikës së Kosovës;
- B. Një (1) anëtar sipas detyrës zyrtare, i emëruar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës;
- C. Katër (4) anëtarë të pavarur, të emëruar nga donatorët; dhe
- D. Drejtori menaxhues i FKGK-së sipas detyrës zyrtare.

## ANËTARËT E BORDIT TË DREJTORËVE TË FKGK-SË NË VITIN 2021:

### KRESHNIK KURTISHI

Anëtar i  
pavarur i Bordit



### RINOR GJONBALAJ

Kryetar i Bordit  
dhe anëtar i  
pavarur i Bordit



### MELIH CADIRCI

Anëtar i  
pavarur i Bordit



### ARTA HOXHA

Anëtare e  
pavarur e Bordit



### NOL BUZHALA

Anëtar i Bordit  
sipas detyrës zyrtare



### BESNIK BERISHA

Drejtor menaxhues  
i FKGK-së



### SALVADOR ELMAZI

Anëtar i Bordit  
sipas detyrës zyrtare



# KCGF STAFF MEMBERS

EKIPI I FKGGK-SË NË VITIN 2021



Nga e majta në të djathtë:

**BESNIK BERISHA**  
Drejtor menaxhues;

**ALBAN KASTRATI**  
Menaxher i lartë i riskut;

**VJOSA BALAJ**  
Menaxhere e lartë e financave dhe e administratës;

**BLERT GJINOLLI**  
Ekspert mjedisor dhe social;

**VILSON UKAJ**  
Zyrtar i lartë ligjor dhe sekretar i Bordit të Drejtorëve;

**JETON REXHEPI**  
Ekspert i riskut kreditor për financim të projekteve;

**NORA ARIFI**  
Menaxhere e lartë e garancive;

**VERË KADRIU**  
Asistente për administratë dhe për përkthime;


**KASTRIOT KËPUSKA**  
Agro ekspert;

**ANITA TOÇI<sup>1</sup>**  
Specialiste për marketing dhe marrëdhënie me publikun

**BURBUQE GURI**  
Asistente e financave dhe administratës;

<sup>1</sup> Nga data 01.09.2021 znj. Anita Toçi i është bashkangjitur ekipit të FKGGK-së.

# STRUKTURA ORGANIZATIVE



Numri i personelit të rregullt të FKGK-së është gjashtë, pëderisa pesë staf janë të angazhuar në implementim të projekteve nga donatorët:

**AGRO EKSPERT** – angazhuar në zhvillimin e Agro Dritares, projekt i mbështetur nga KfW;

**EKSPERTI I RISKUT KREDITOR PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE** – angazhuar në implementim dhe zhvillim të dritares së energjisë, projekt i mbështetur nga MCC/MFK;

**ASISTENTE FINANCIARE DHE ADMINISTRATËS** – angazhuar në implementim dhe zhvillim të dritares së energjisë, projekt i mbështetur nga MCC/MFK

**EKSPERTI MJEDISOR DHE SOCIAL** – përgjegjës për implementimin e SMMS, angazhuar në kuadër të PFSF me BB.

**SPECIALISTJA PËR MARKETING DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN** – angazhuar me në kuadër të PFSF me BB.



# KOMITETET

## KOMITETI I MENAXHIMIT TË RISKUT

Komiteti për Menaxhimin e Riskut është themeluar në bazë të Ligjit për FKGK-në. Komiteti i Menaxhimit të Riskut ndihmon Bordin e Drejtorëve me fokus të specializuar në fushën e menaxhimit të riskut. Komiteti i Menaxhimit të Riskut mbledhet së paku në baza kuartale dhe përbëhet nga tre (3) anëtarë të Bordit, përderisa menaxheri i lartë i Riskut është pjesëmarrës i përhershëm i Komitetit.

Si i tillë, Komiteti shqyrton politikat e riskut kreditor dhe operativ, mbikëqyr zhvillimet e portofolit të garantuar dhe siguron që profili i riskut kreditor është në përputhshmëri me politikat kreditore, me ligjet dhe me rregulloret e zbatueshme.

## KOMITETI I AUDITIMIT

Komiteti i Auditimit është i themeluar në bazë të Ligjit për FKGK-në. Komiteti i Auditimit përbëhet nga katër (4) anëtarë të Bordit dhe takimet mbahen në baza tremujore.

Ky komiteti është përgjegjës për dhënien e rekomandimeve Bordit të Drejtorëve për çështjet e menaxhimit të rrezikut, të kontrollit të brendshëm, pasqyrave financiare, kërkesave të pajtueshmërisë, auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, poashtu funksioneve të tjera relevante të qeverisjes së FKGK-së. Përveç kësaj, Komiteti i Auditimit rishikon kontrollet e brendshme financiare, operative dhe administrative.

# BASHKËPUNËTORËT E FKGGK-SË

Për t'i arritur objektivat dhe synimet FKGGK-ja bashkëpunon me institucionet financiare (bankat, IMF-të, IJF-të), me donatorët, me Qeverinë e Republikës së Kosovës, me Bankën Qendrore të Kosovës dhe me Komunitetin e NMVM-ve.

## DONATORËT

- Qeveria e Republikës së Kosovës
- Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)
- Banka Gjermane për Zhvillim (KfW)

## BASHKËPUNËTORËT

- Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar e përfaqësuar nga Ambasada Suedeze
- Banka Botërore
- Fondi Evropian për Investime
- Fondacioni Kosovar i Mileniumit

## INSTITUCIONET E REGJISTRUARA FINANCIARE

- Banka Ekonomike
- Banka Kombëtare Tregtare
- Banka për Biznes
- NLB Banka
- ProCredit Bank
- Raiffeisen Bank
- TEB
- Raiffeisen Leasing Kosovë
- KEP
- FINCA
- KRK



# TAKIMET E BORDIT TË DREJTORËVE DHE TË KOMITETEVE PËRKATËSE

## MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE TË FKGK-SË

Gjatë vitit 2021 Bordi i Drejtorëve i FKGK-së mbajti gjithsej katër (4) mbledhje të rregullta. Në mbledhjet e bordit janë marrë disa vendime të rëndësishme për zhvillimin e mëtutjeshëm të FKGK-së, dhe marrëdhëniet e FKGK-së me palët e treta.

## MBLEDHJET E KOMITETIT PËR MENAXHIM TË RISKUT KREDITOR DHE TË KOMITETIT TË AUDITIMIT

Gjatë vitit 2021 Komiteti për Menaxhim të Rrezikut Kreditor (MRK) mbajti katër (4) mbledhje të rregullta dhe Komiteti i Auditimit (KA) mbajti katër (4) mbledhje të rregullta. Në këto takime komitetet përkatëse nxorën vendime dhe rekomandime për menaxhmentin e FKGK-së dhe për miratimin përfundimtar nga Bordi i Drejtorëve i FKGK-së.

*Tabela në vijim paraqet mbledhjet e Bordit dhe të komiteteve ndihmëse të Bordit të Drejtorëve të FKGK-së:*

Orari i mbledhjeve të Bordit	Pjesëmarrja e anëtarëve të Bordit	Numri i temave të diskutuara	Numri i vendimeve të nxjerra
19 mars 2021	7/7	13	6
18 qershor 2021	7/7	13	6
17 shtator 2021	7/7	15	13
15 dhjetor 2021	7/7	18	8
<b>Gjithsej:</b>		<b>59</b>	<b>33</b>

Orari i mbledhjeve të KMR-së	Pjesëmarrja e anëtarëve të KMR-së	Numri i temave të diskutuara	Numri i vendimeve/ i rekomandimeve të marra
03 mars 2021	4/4	9	4
02 qershor 2021	4/4	8	3
09 shtator 2021	4/4	10	5
30 nëntor 2021	4/4	8	6
<b>Gjithsej:</b>		<b>35</b>	<b>18</b>

Orari i mbledhjeve të KA-së	Pjesëmarrja e anëtarëve të KA-së	Numri i temave të diskutuara	Numri i vendimeve/ i rekomandimeve të marra
05 mars 2021	4/4	6	0
09 qershor 2021	4/4	7	0
03 shtator 2021	4/4	7	1
08 dhjetor 2021	4/4	7	1
<b>Gjithsej:</b>		<b>27</b>	<b>1</b>



# PJESA IV






# PERFORMANCA E FKGGK-së

# ZHVILLIMI I PORTOFOLIT TË GARANCIVE


## SFIDAT E FKGK DREJT RITJES

Viti 2021 ishte një vit sa sfidues po aq i suksesshëm për FKGK-në e cila vazhdoi të ofrojë garanci kreditorë për NMVM-të, duke ndarë rrezikun kreditor me institucionet financiare në një nivel edhe më të lartë se vitet e kaluara. Përgjatë gjithë periudhës së pandemisë, FKGK ka vazhduar të mbajë hapur dritaret ekzistuese garantuese dhe përkundër rritjes së perceptimit të riskut në treg dhe pa parashikueshmërisë së rrjedhës së ngjarjeve FKGK hapi edhe dritaret e reja në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike me kushte edhe më të favorshme siç është rritja e shkallës së garancisë nga 50% në 80%. Hapja e Dritareve në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike ishte një nga nxitëset e zhvillimit të garancive të reja gjatë vitit që shkoi, ku rritja e shkallës së garancisë dhe subvencionimi i tarifave të garancisë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, rriti besimin tek institucionet financiare partnere, rrjedhimisht, duke sjellur rritje të qasjes në financa për NMVM-të përmes skemës së garancisë së FKGK-së.

Gjatë vitit 2021 në sajë të ndërmjetësimit të FKGK-së u mundësua kredidhënia në sektor me vlerë prej 179.75 milionë euro shpërndarë në 3,961 kredi për 3,315 NMVM (përfshirë 224 fermerë me numër identifikues të fermerit), të mbështetur nga një shumë garancie prej 111.05 milionë eurosh. Shuma kumulative e kredive të miratuara në fund të vitit arriti vlerën prej 408.73 milionë eurosh për 7,767 NMVM, e mbështetur nga një shumë kumulative e garancive prej 221.83 milionë euro.




Vlera totale e mbetur e portofolit të kredive, në fund të vitit 2021, ishte 216.45 milionë euro, përdërisa vlera totale e mbetur e portofolit të garantuar ishte 126 milionë euro shpërndarë në 6,670 kredi aktive.



## RRETH 98% E PORTOFOLIT PËRBËHET NGA NDERMARRJET MIKRO DHE TË VOGLA

Portofoli i garantuar edhe gjatë 2021, vazhdon të ketë pjesëmarrje më të madhe nga ndërmarrjet mikro. Përqendrimi i portofolit të garantuar sipas numrit të punëtorëve ishte në segmentin e ndërmarrjeve të mikro dhe të vogla deri në 49 punëtorë.




Një distribuim i tillë i portofolit të garancisë është një reflektim i sektorit privat të vendit tonë por edhe me orientimin Institucionit tonë drejt qasjes në financa për këtë segment.

## GARANCITË KREDITORE SIPAS SEKTORËVE TË EKONOMISË

Stimulimi i sektorëve që krijojnë vlerë të shtuar për ekonominë si dhe diversifikimi sa më i mirë mbetën një nga objektivat e FKGK-së. Për këtë FKGK me ndihmën e donatorëve dhe partnerëve të saj ka punuar në vazhdimësi në ndërtimin e produkteve të cilët do të mbështesin Rimëkëmbjen Ekonomike me fokus të veçantë drejt fuqizimit të sektorëve strategjik.

Një fokus i tillë i dhënë nga FKGK ndikoi që në vitin 2021 të kemi një lëvizje të theksuar të trendit të shfrytëzimit të garancive kreditore krahasuar me vitet paraprake edhe pse në përgjithësi si pjesëmarrje prezanton trendin e ekonomisë së vendit tonë.



Sektori më dominues në portofolion e kredive të garantuara gjatë vitit 2021 ishte ai i tregtisë me pakicë dhe me shumicë me 40%, i vijuar nga prodhimi me 24%, shërbimi me 22%, ndërtimtaria me 8% dhe bujqësia me 6%. Në krahasim me një vit më parë, lëvizja nëpër sektor vërehet sidomos në sektorin e prodhimit në të cilin kishim një rritje prej 30% (24% nga 17% sa ishte një vit më parë) dhe në sektorin e shërbimeve, rënie në sektorin e tregtisë, ndërtimtarisë dhe bujqësisë të cilët ishin të ndikuar nga mbyllja mu në sezonin e investimeve në këta sektor, për arsye të situatës pandemike.

Përderisa sektori i bujqësisë ka vazhduar të ketë pjesëmarrje të ulët diku në 2.5% në gjithsej sektorin bankar, kjo pjesëmarrje në gjithsej në portofolin aktive të FKGK-së në fund të vitit 2021 ishte 9.7%.


Stimulimi i sektorëve që krijojnë vlerë të shtuar për ekonominë siç janë bujqësia, prodhimi e shërbimi si dhe fuqizimi i segmenteve të marginalizuar siç janë gratë në biznes dhe startup-ët janë një nga objektivat tona. Ndaj dhe së bashku me partnerët e FKGK-së është duke u punuar në drejtim të fuqizimit të këtyre sektorëve si edhe sektorëve të tjerë më pak të shërbyer duke konsideruar se këto janë forca lëvizëse të ekonomisë dhe kontribuese në rritje të punësimit e në ngritjen e mirëqenies sociale në përgjithësi.

## INVESTIMET PËR KAPITAL QARKULLUES DHE QËLLIME MIKSE<sup>2</sup> ME DOMINIM MË TË LARTË

Dritaret e garancisë së FKGK-së janë dizajnuar për të mbështetur NMVM-të që të ndërmarrin investime afatgjata në bizneset e tyre dhe për këtë këto garanci ofrohen me maturitet 10 vjeçar.

Gjatë 2021, investimet afatgjata patën një pjesëmarrje mjaft reprezentative prej 40%, ndonëse pjesëmarrja e investimeve afatshkurtra ishte më dominuese e që ndërlidhet me kërkesën për kredi për kapital punues (kredi afatshkurtra, mbritërheqje e linja kreditore) dhe zhvillimet ekonomike gjatë periudhës së pandemisë, të cilat na dhanë indikacione për presionin e cash-flow gjatë 2021.

Për më shumë, në vitin 2021, 24% e kredive të aprovuara ishin investuar në pajisje (makineri të prodhimit, pajisje bujqësore, pajisje të tjera); 16% në tokë, në ndërtim ose në rinovim; 53% për kapital punues dhe 7% në të tjera.




<sup>2</sup> Në praktikë nëse një kredidhënie ka për qëllim investime të bëra njëkohësisht; në kapital punues, asete fikse, renovim apo edhe ndërtim, atëherë kjo shënohet me destinacioni qëllime mikse.

## SHFRYTËZIMI I GARANCIVE NË REGJIONE TË NDRYSHME

Shfrytëzimi i garancive në regjione të ndryshme edhe në 2021-n përcolli trendin e viteve paraprake. Regjioni i Prishtinës kishte pjesëmarrje më të madhe në portofolin e kredive të garantuara, me një pjesëmarrje prej 61%.

Një shpërndarje e tillë e portofolit konsiderohet të jetë në linjë me shpërndarjen e portofolit kreditor të sektorit bankar në regjione përkatëse.



# DRITARJA AGRO - ZHVILLIMI/RISITË

## Garantimi i agro financimit përmes Dritares Agro

FKGK e konsideron shumë të rëndësishëm financimin dhe garantimin e sektorit të bujqësisë, duke e parë si sektor i cili luan një rol pozitiv të theksuar në gjenerimin e punësimit dhe zvogëlimin e shkallës së lartë të papunësisë. Aktivitetet në këtë sektor, konsiderohen një mundësi e mirë e gjenerimit të të hyrave, si nga projektet e mëdha, po ashtu edhe nga ato projekte investive të cilat kanë nevojë për investime më të vogla. Këto investime, njëherit, si rezultat final e kanë edhe punësimin dhe zgjidhjen e çështjeve sociale për shumë familje, sidomos atyre në zonat rurale të vendit.

FKGK-ja vazhdon ta ketë një ndër objektivat më të rëndësishëm mbështetjen e zhvillimit të sektorit të bujqësisë përmes garantimit të kredive agro përgjatë tërë zinxhirit të shtimit të vlerës brenda këtij sektori.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ka vazhduar të garantojë sektorin e bujqësisë edhe gjatë pandemisë COVID-19 duke vazhduar ta përkrahë tutje këtë sektor dhe ta ketë në fokus të veçantë.

Deri në fund të vitit 2021, FKGK-ja ka nënshkruar marrëveshje për Dritaren Agro me 7 banka dhe 3 Institucione Mikrofinanciare (IMF) të FKGK-së që janë aktive në agro kredi dhënie, përdërisa ka filluar të nisë procesin e regjistrimit të IMF-së të katërt me radhë.

Një pikë kthese për regjistrimin e IMF-së në FKGK ishte edhe mundësia që iu ofrua institucioneve financiare për të garantuar kreditë që u jepen fermerëve që posedojnë Certifikatë të Fermerit dhe Numër Identifikues të Fermës (NIF), e cila mundësi nuk ishte më parë.

Kjo është mundësuar gjatë vitit 2021, periudhë kjo që përkon me kohën kur ka qenë aktive dhe është zbatuar Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike (PRE) nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK). Kjo pako, përpos mundësisë së garantimit të fermerëve që posedojnë NIF, ua mundësoi institucioneve financiare partnere edhe garantimin deri në 80% të agro kredisë.


Gjatë vitit 2021 janë miratuar gjithsej rreth 15,7 milionë € kredi të reja nga IFP-të në sektorin e bujqësisë të cilat janë vënë nën garancionin e FKGK-së, prej të cilave 8.7 milionë € në Dritaren Agro dhe 7.0 milionë € të tjera brenda PRE-së.

Kjo paraqet rreth 131 % rritje të volumit të kredive të garantuara krahasuar me vitin paraprak 2020 (apo rreth 65% rritje krahasuar me vitin 2019), e cila rritje ka ardhur si rrjedhojë e rritjes së kreditimit gjatë periudhës së fillimit të rimëkëmbjes pas pandemisë. Gjithashtu edhe numri i kredive të garantuara është rritur nga 202 në 469 që i bie për 132% krahasuar me vitin paraprak (apo rreth 108% krahasuar me vitin 2019).

Shuma mesatare e kredive të garantuara në Dritaren Agro gjatë 2021 ishte rreth 33.4K € me maturitet mesatar mbi 39 muaj (rritje nga 35.7 muaj që ishte një vit më herët).








# SHTUESHMËRIA

Shtueshmëria është arsyeja thelbësore për themelimin e FK GK-së. Kjo do të thotë se bankat, Insitucionet Mikro Financiare ose Institucionet Financiare jo Bankare nuk do t'i lëshonin një NMVM-je kredi pa garancinë e dhënë, duke shtuar kështu një klient të ri dhe duke kontribuar në rritjen ekonomike.

Për ta vërejtur këtë impakt, FK GK ka analizuar indikatorët e ndërlidhur me shtueshmërinë financiare duke reflektuar në të dhënat e siguruara nga Regjistri Kreditor i Kosovës dhe të dhënat e siguruara nga MIS i brendshëm i FK GK-së. Me këtë rast u analizuan dhe u krahasuan kreditë e lejuara në sektor gjatë 2021 me kreditë e lejuara në sektor por të garantuara nga FK GK.

Rëzultatet e monitorimit të këtyre indikatorëve na treguan se si në sajë të aktivitetit të FK GK-së në përgjithësi është rritur qasja në financa dhe janë relaksuar standardet e kredidhënies.



## PJESËMARRJA E KREDIVE TË GARANTUARA NË SEKTORIN BANKAR


Ndikimi i FKGK-së në aktivitetin e kredi dhënies në sektorin bankar e që për NMVM-të nënkupton qasje më e madhe në financa, në 2021 rezultoi me rritje të pjesëmarrjes së kredive të garantuara në sektorin bankar edhe këtë vit.

Pjesëmarrja (vlerë financiare) në kategorinë e kredive deri në 100,000 euro ishte 30%, ndërsa vetëm në kategorinë 25,000-50,000 euro ishte 37%.

Ky indikator shënoi një rritje prej 80%, krahasuar me vitin 2020 në të cilin pjesëmarrja ishte 17%. Kjo rritje e jashtëzakonshme vie pikërisht për shkak të aktivitetit të shtuar që kishte FKGK gjatë rimëkëmbjes ekonomike, përmes dritareve

specifike të cilat adresuan kërkesat e tregut gjatë rimëkëmbjes ekonomike. Në këtë mënyrë skema e garancisë kreditore e FKGK-së shtoi tutje ndikimin pozitiv në ndërmjetësimin financiar. Kjo gjithashtu mund të vërehet edhe në pjesëmarrjen e kredive të garantuara në numër ku çdo e katërta kredi e lëshuar në sektor në vlerën deri 100,000 euro ishte kredi e garantuar nga FKGK.

Sa më e madhe të jetë pjesëmarrja, kjo nënkupton ndikimin e FKGK-së në aktivitetin e kredidhënies në sektorin bankar e që për NMVM-të nënkupton qasje më e madhe në financa. Arsyeya e reflektimit në kategorinë deri në 100,000 euro është për shkak se profili i klientëve në portofolin e FKGK-së i takon këtij segmenti në treg.




## MESATARJA E MATURITETIT TË KREDISË - KOHËZGJATJE MË E LARTË E KREDIVE

Portofoli i garantuar gjatë 2021-s vazhdoi të përbëhej nga kredi afatmesme me një mesatare prej 36 muajsh. Mesatarja e maturitetit të kredisë si indikator i shtueshmërisë financiare në këtë vit tregoi përsëri rritje të maturitetit të kredive të garantuara krahasuar me kreditë e pagantuara. Sa më i gjatë maturiteti do të thotë kushte më të mira financimi për kredimarrësit, ndërsa risk më i lartë për kredidhënësit.

Kohëzgjatja mesatare e kredive të garantuara deri në 100,000 euro ishte 36 muaj apo për 20% më e lartë se mesatarja e kredive të pa garantuara. Ky indikator gjatë vitit 2021-s sikur edhe në vitin 2020, rezultoi në një standard më relaksues të riskut nga ana e IRF-ve, ndaj edhe kushte më të mira të kredi marrjes për NMVM-të e që për NMVM-në çdo rritje e maturitetit do të rritë kapacitetin e kredi marrësit për kompletuar investimin e planifikuar.

### MESATARJA E MATURITETIT TË KREDISË




## MBULUESHMËRIA ME KOLATERAL

Kolaterali, shumë shpesh është një nga arsyet e refuzimit të aplikacionit të kredisë ose një nga arsyet e zvogëlimit të shumës së kredisë së aplikuar. Ndaj, në rastin e impaktit të skemës së garancisë, kërkesa më e ulët për kolateral, nënkupton parasegjithash përfshirje financiare,

kushte më të mira të kredidhënies për klientët, kohë më të shkurtër për përpunimin e aplikacionit për kredi dhe kosto më të ulët të huamarrjes. Në 2021-n skema e garancisë së FKGK-së rezultoi me një ndikim pozitiv duke zvogëluar kërkesën për kolateral për 74%.


### DIFERENCA E KËRKESËS PËR KOLATERAL



## KLIENTËT E RINJ / PËRFSHIRJA FINANCIARE

Pjesëmarrja më e lartë e kësaj kategorie të klientëve (të cilët nuk kanë marr kredi asnjëherë) në portofolin e përgjithshëm të klientëve të kredisë, nënkupton perceptimin më të ulët të rrezikut nga bankat, në lidhje me ndërmarrjet e krijuara rishtazi, pra niveli më i lartë i përfshirjes financiare për bizneset e reja. Pjesëmarrja e kredive të garantuara për biznese të reja pa përvojë të mëhershme të

kredi marrjes në 2021-n në kategorinë e kredive deri në EUR 100K euro ishte 33%, apo 30% më e lartë se pjesëmarrja e kredive të pa garantuara e të njëjtit segment. Ky raport pasqyron ndikimin e FKGK-së në përfshirjen financiare të sektorit privat pa eksperiencë të mëhershme kreditore, ndaj edhe ndikimin pozitiv në sektorin financiar dhe në ekonominë në përgjithësi.



## SHUMË MESATARE MË E LARTË E KREDIVE TË GARANTUARA

Portofoli i FKGK edhe në fund të vitit 2021 ishte i populluar nga ndërmarrje të kategorisë së vogël, me vlerë kreditore mesatare prej rreth 34K euro. Kjo vlerë përputhet me kategorinë e vogël të ndërmarrjeve të cilat kanë mungesë të kolateralit, andaj edhe nevojë për mbështetje financiare, por edhe për kërkesën gjatë këtij viti e cila ishte kryesisht për kapital qarkullues. Gjithashtu, ky vit rezultoi me shumë mesatare më të lartë të kredive

të garantuara për 35% në krahasim me kreditë e pa garantuara në kategorinë e kredive deri në EUR 100K. Ngritja e shumës mesatare e kredisë përmes ndërmjetësimit të FKGK për këtë kategori, reflekton në ndikimin e skemës garantuese në standarde më të mira të kredidhënies nga ana e bankave gjatë procesit të miratimit të kredisë edhe për NMVM për herë të parë financuara në sektorin bankar.



## PJESËMARRJA E BIZNESEVE TË GARANTUARA NË RAPORT ME TË GJITHA BIZNESET AKTIVE NË EKONOMINË REALE

Pjesëmarrja e kredive të garantuara nga FKGK për biznese taksapaguese është një tregues tjetër i rëndësishëm i përfshirjes së NMVM-ve në skemën e garancisë. Bazuar në informatat që janë siguruar nga Administrata Tatimore e Kosovës, në vitin 2021 kishim përafërsisht 59,863 biznese aktive (biznese tatimpaguese), ndërsa numri i NMVM-ve të cilat përfituan nga garancitë kreditore të FKGK-së deri në 2021 ishte 5,075 duke e sjellë pjesëmarrjen e NMVM-ve të garantuara në sektorin e NMVM-ve në 8% në fund të vitit 2021. Kjo pjesëmarrje është duke u rritur nga viti në vit, duke e pasqyruar kështu rëndësinë e FKGK-së si dorë e zgjatur për zhvillimin e sektorit të NMVM-ve dhe ekonomisë në përgjithësi.

## PJESËMARRJA E VOLUMIT TË KREDIVE AKTIVE TË GARANTUARA NGA FKGK NË BPV

Për të kuptuar rëndësinë që luan instrumenti i garancisë së FKGK-së në ekonominë kombëtare të vendit tonë, kemi llogaritur pjesëmarrjen e volumit të kredive aktive të garantuara nga FKGK në bruto produktin e vendit (BPV) deri në fund të vitit 2021. Kjo pjesëmarrje në fund të 2021 ishte 1.6% duke shënuar rritje në krahasim me 2020 për 100% (në fund të vitit 2020 ky raport ishte 0.8%).

Një rritje e tillë e pjesëmarrjes së volumit të kredive të garantuara në totalin e kredive në sektor (kreditë për NMVM-të) si dhe në BPV-në e Kosovës është një sinjal pozitiv drejt zvogimit të hendekut të kreditimit në raport me BPV-në e vendit tonë.

## KREDITË PËR GRATË NË BIZNES

Ky tregues paraqet gjithëpërfshirjen e grave pronare të NMVM-ve në procesin e kredimarrjes. Gratë marrin pjesë në një shkallë më të ulët të kredimarrjes formale në raport me burra e cila është rreth 12% në sektorin bankar. Një ndër barrierat kryesore për gratë në biznes është mungesa e pengut të mjaftueshëm e cila vështirëson qasjen në financa për këtë kategori. Në anën tjetër edhe pandemia COVID-19 ka ndikuar negativisht në NMVM-të me udhëheqëse gra pikërisht për shkak të kapacitetit më të kufizuar apo edhe përqëndrimit të tyre në sektorë më të goditur nga pandemia. Pikërisht për këtë FKGK-ja ka vënë në objektivat institucionale, mundësi më të mira për sektorët dhe për kategoritë më pak të shërbyera ekonomike dhe të popullsisë, duke përfshirë gratë. Gjatë vitit 2021 pjesëmarrja e grave në biznes në gjithsej portofolin e garantuar të FKGK-së ishte 14%. Një pjesëmarrje e tillë krahasuar me pjesëmarrjen e grave në biznes në gjithsej kredidhënien në sektorin bankar është një mesazh që impakti i garancisë kreditore të FKGK-së ka filluar të vërehet edhe në këtë segment të synuar.



### SHPERNDARJA SIPAS GJINISE

86% MESHKUJ

14% FEMRA



# MENAXHIMI I RISKUT KREDITOR

Veprimtaria e FKGK-së është e ndërlidhur me marrje të rrezikut, përmes garantimit të pjesëshëm të kredive për NMVM-të, të cilat janë vlerësuar nga Institucionet e Regjistruara Financiare (IRF). Si rrjedhojë, rreziku kreditor që buron nga asimetria e informatave, mungesa e kolateralit apo rreziqe të tjera gjatë kreditimit të NMVM-ve, bëhet po ashtu pjesë e riskut të FKGK-së për kreditë e garantuara. Duke qenë se FKGK-ja nuk merr pjesë në vlerësimin e rrezikut të kredisë, proceset janë ndërtuar në mënyrë që të sigurojnë menaxhimin e duhur të rrezikut përmes mekanizmave të duhur të monitorimit dhe kontrollit "ex-ante" dhe "ex-post". Qasja në menaxhimin e rrezikut fillon me identifikimin dhe analizimin e rreziqeve me të cilat përballet FKGK-ja, për të vazhduar me vendosjen e kontrolleve të duhura për menaxhimin dhe mitigimin e rrezikut, si dhe ndërtimin e sistemit adekuat të monitorimit të rrezikut. Menaxhimi dhe mitigimi i rrezikut në FKGK, zhvillohet përmes:

- Përcaktimit të potencialit garantues si dhe kufijve maksimalë të humbjes. Ky proces i siguron FKGK-së që niveli i ekspozimit si dhe i rrezikut të jetë brenda kufijve të lejuar;
- Përcaktimit të kushteve dhe të kriterëve të qarta kualifikuese për IFP, për NMVM-të si dhe për kreditë që kualifikohen;
- Diversifikimit të Portfolios, në nivel të:
  - *IRF-ve, përmes ndarjes së limiteve garantuese;*
  - *NMVM-ve, përmes përcaktimit të ekspozimit maksimal garantues;*
  - *Diversifikimit në nivel të sektorëve;*
- Rigarantimit të portfolios përmes skemave garantuese nga institucione kredibile, duke mundësuar ndarjen e rrezikut për kreditë e garantuara;
- Monitorimit dhe kontrollit të rregullt në nivel të:
  - *Sektorit financiar;*
  - *IRF-ve;*
  - *Kredimarrësve të garantuar.*

## AKTIVITETET PËR MENAXHIMIN E RISKUT GJATË VITIT 2021

Në përputhje me politikat dhe proceset e brendshme, FKGK-ja vlerësoi dhe regjistroi tri (3) institucione mikrofinanciare, zhvilloi rivlerësimin vjetor të të gjithë IFR-ve, shqyrtoi dhe miratoi kërkesat për rivlerësimin e limiteve të IRF-ve gjatë vitit 2021, shqyrtoi dhe modifikoi politikat e brendshme në përputhje me modifikimet e bëra në dritaret përkatëse, menaxhoi në mënyrë efektive rrezikun e perceptuar nga pandemia globale COVID-19. Përveç kësaj, gjatë vitit të kaluar FKGK-ja vazhdoi praktikën e mbledhjeve të rregullta

mujore, ku analizohen trendet në sektorin bankar në përgjithësi dhe në veçanti për secilën IRF, si dhe analizohet zhvillimi i portofolit të garantuar. Brenda kapaciteteve ekzistuese, FKGK-ja vazhdoi rritjen e limiteve garantuese ndaj IRF, duke i shtuar limitet garantuese për pothuajse 89.4 milionë euro gjatë vitit 2021, duke ngritur limitet e përgjithshme të ndara ndaj IRF-të në 174.75 milionë euro. Gjatë vitit 2021 FKGK-ja shfrytëzoi gjithë limitin e alokuar nga skema rigarantuese COSME (program i EIF) që ofron mundësinë e ndarjes së rrezikut përmes mbulimit me 50% të kredive të garantuara nga FKGK-ja që kualifikohen për Programin COSME. Skemat rigarantuese nga COSME dhe SIDA i kanë mundësuar FKGK-në ndarjen e pjesëshme të riskut kreditor, rritjen e kapacitetit garantues, uljen e shpenzimeve të provizionit, por edhe zvogëlimin e tarifave për kredi janë kualifikuar për skemën COSME. Krahas aktiviteteve të zhvilluara, FKGK-ja vazhdoi të përmirësojë procesin menaxhimit të rrezikut përmes adaptimit të politikës së menaxhimit të riskut për garanci kreditorë si dhe adaptimit të politikës së provizionimit.

## MENAXHIMI I RISKUT NGA SITUATA E KRIJUAR NGA COVID 19

Lehtësimi i masave si dhe marrja e masave mbështetëse ekonomike nga Qeveria e Kosovës, ndikuan mjaft në rritjen e aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2021, përkundër që pandemia COVID-19 vijoi të jetë e pranishme edhe gjatë vitit 2021, por tanimë në versione të ndryshme. Megjithatë, rimëkëmbja pas pandemisë u shoqërua me presione inflacioniste, veçanërisht në pjesën e dytë të vitit, të ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të importeve, sfida që vijon të na përcjellë. Përkundër sfidave të reja të paraqitura, FKGK-ja vijoi nxitjen e kreditimit nga IRF-të, në mënyrë që nxitet zhvillimi i NMVM-ve, krahas menaxhimit sa më efektiv të rrezikut. Pas miratimit të Ligjit të Rimëkëmbjes Ekonomike, në janar të 2021-tës, FKGK-ja filloi zbatimin e masave që përcaktohen në Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike të cilat parashihnin rritje të mbulueshmërisë së garancionit deri në 80% për sektorët e prekur nga pandemia si dhe subvencionimi i tarifave të garancionit nga Qeveria e Kosovës. Pas ndarjes së kapitalit shtesë, FKGK-ja alokoi limite shtesë të Institucionet e Regjistruara Financiare, të cilat mundësuan garantimin e kredive të reja në vlerë prej 105.5 milionë eurosh, pjesa e garantuar e së cilës ishte në vlerë 74,9 milionë euro, të shpërndara në 2015 kredi. Masat e ndërmarra nga gjithë akterët ndikuan në sektorin financiar, duke nxitur rritjen e


kreditimit si dhe rritjen e aktivitetit ekonomik e që sipas të dhënave nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ishte 10.5%. Sektori financiar në Kosovë edhe gjatë kësaj periudhe vazhdoi të mbetet likuid e i shëndoshë, dhe me rezerva të mjaftueshme të provizionit. Krahas kësaj, FKGG-ja vijon monitorim e klientëve në sektorët e rrezikuar, si dhe mbajtjen e rezervave shtesë të provizionit me qëllim që të sigurojë që ka mbulueshmëri të mjaftueshme në rast të përkeqësimit të kredive si rezultat i ndikimit të pandemisë.

## KUALITETI I PORTOFOLIT


Rritja e mbulueshmërisë dhe alokimi i limiteve të reja përmes Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike shërbeu si katalizator për rritje të kreditimit në sektorin financiar në Kosovë dhe rrjedhimisht ndikoi në rritjen e aktivitetit ekonomik. Si rrjedhojë, FKGG-ja shënoi rritje rekorde të portofolit të garantuar në vitin 2021, përderisa gjithë indikatorët e tjerë të performancës ishin në nivel të pranueshëm. Bilanci garantues sipas të dhënave më 31 dhjetor 2021 ishte në vlerë prej 126.09 milionë eurosh, përderisa kapitali i FKGG-së ishte 55,2 milionë euro që rezultoi që raporti i levës më 31 dhjetor 2021 ishte 2.27% (çdo 1 euro kapital është multiplifikuar me 2.27 euro garancion kreditor). Krahas kapitalit duhet theksuar që 13.8 milionë euro ishte pjesa e rigarantuar nga SIDA dhe nga programi COSME nga EIF, që rezultoi që 11% e gjithëj portofolit është rigarantuar. Rigarantimi i portofolit ka mundësuar ndarje të riskut, por gjithashtu ka shërbyer edhe si formë e kuazi kapitalit, meqenëse ka mundësuar

alokime shtesë të limiteve garantuese të IFR-të. Siç paraqitet në tabelën e ilustruar mund të vërehet që pjesa dominuese e bilancit të garantuar është ndërtuar nga garancionet e vendosura në vitin 2021, pasi pjesëmarrja e këtij viti në bilancin total të garantuar është rreth 76% nga i gjithë bilanci i garantuar, përderisa portofoli nga vitet paraprake në masë të madhe është amortizuar. Kualiteti i portofolit i matur me kreditë delikuede dhe joperfomuese shënoi zvogëlim gjatë vitit 2021, që ishte kryesisht si rrjedhojë e rritjes së portofolit të garantuar, që pothuajse dominohet nga kreditë e garantuara në vitin 2021. Sipas të dhënave të fundvitit, më 31 dhjetor 2021, delikuenca e kredive të garantuara ishte 1.55% përderisa vlera e saj ishte 1.95 milion euro, përderisa KJP-ja ishte 1.25% përderisa vlera e saj ishte 1.58 milion euro. Viti 2021 shënon vazhdimin e paraqitjes së kërkesave për pagesë nga IFR-të. Gjithë kërkesat e paraqitura nga IRF për kreditë e kualifikuara janë vlerësuar në përputhje me marrëveshjen e garancisë dhe politikat internale të FKGG-së. Gjatë vitit 2021 FKGG-ja vazhdoi të qëndrojë prapa obligimeve të saj për të paguar kërkesat për kreditë e garantuara, duke paguar kërkesa gjithsej në vlerë prej 223.3K eurosh, përderisa vlera e përgjithshme e kërkesave të paguara përfshirë vitet paraprake arriti vlerën 534.5K euro, që në raport me bilancin e garantuar është 0.42%. Shqyrtimi me kohë i kërkesave për pagesa dhe vlerësimi i tyre në përputhje me marrëveshjen garantuese paraqet seriozitetin e FKGG-së dhe rrit besueshmërinë ndaj partnerëve të saj.

### AMORTIZIMI I PORTOFOLIT NËPËR VITE




### BILANCI GARANTUES SIPAS VITEVE





## PËRFORMANCA E KREDIVE TË GARANTUARA NË VITIN 2021



## ZBATIMI I STANDARDEVE TË SNFR 9

Krahas menaxhimit të punëve dhe proceseve të rregullta, në vitin 2021 FKGK-ja ishte e përkushtuar në zbatimin e standardeve SNFR 9, e cila merr parasysh performancën e kaluar për të vlerësuar humbjet e pritshme nga kreditë e garantuara, ndikuar edhe nga zhvillimi i faktorëve makroekonomikë. Zbatimi i SNFR 9 ishte mjaft sfidues, meqenëse nevojitej njohuri për ta përshtatur modelin e funksionimit të FKGK-së me kërkesat e SNFR 9. Si rezultat i zbatimit të SNFR 9, tani FKGK-ja ka informata shtesë mbi humbjet e pritura, të dhëna të cilat do

të shfrytëzohen jo vetëm për ndarjen e rezervave të provizionimit, por edhe për përshtatjen e tarifave garantuese me humbjet e pritura. Si rezultat i zbatimit të modelit të SNFR 9, gjithë rezervat për humbjet e pritura për kreditë e garantuara si dhe asetet e tjera arrijnë në 3.57 milionë euro, përderisa në vitin paraprak ato ishin 1.45 mil euro, që është 147% më e lartë se në vitin paraprak. Rezervat totale të provizionit në vitin 2021 janë 2.8% në raport me bilancin e garantuar, përderisa mbulueshmëria e kredive joperformuese është 226%, që është relativisht më e lartë se sektori financiar në Kosovë.

Dritaret	Fazat	Bilanci Garantues	Rezervat e Provizionit	Shkalla e Provizionit
<b>E RREGULLT; PRE; START UP</b>	Faza 1	116,170,371	1,711,516	(3,149.00)
	Faza 2	1,843,917	574,100	179,017.00 €
	Faza 3	1,455,714	906,793	320,012 €
	<b>Totali</b>	<b>119,491,315</b>	<b>3,192,408</b>	<b>484,334 €</b>
<b>AGRO Dritarja</b>	Faza 1	6,366,641	64,887	1.02%
	Faza 2	109,832	27,569	25.10%
	Faza 3	124,326	39,352	31.65%
	<b>Totali</b>	<b>6,600,799</b>	<b>131,809</b>	<b>2.00%</b>
<b>Totali i Garancisë</b>		<b>126,092,114</b>	<b>3,324,217</b>	<b>2.64%</b>
<b>Asete Tjera</b>	Faza 1	51,692,829	246,209	0.48%
	<b>Totali</b>	<b>51,692,829</b>	<b>246,209</b>	<b>0.48%</b>
<b>Total Provizioni</b>			<b>3,570,426</b>	

## STRUKTURA E KAPITALIT DHE INVESTIMET


Kapitali i FKGK-së përbëhet nga fondet e dhuruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga donatorët ndërkombëtarë. Në vitin 2016, kur është themeluar FKGK, shumën e kapitalit të dhuruar të FKGK-së ishte 7,345,141 euro, ndërsa gjatë vitit 2017 kjo vlerë është dyfishuar, duke mbyllur vitin 2017 me kapital të dhuruar në shumën 15,790,921 euro.

Dyfishimi i kapitalit ishte si rezultat i kontributit nga USAID-it, MTI dhe KfW, në fund të muajit dhjetor 2017. Gjatë viteve 2018 dhe 2019, FKGK nuk ka pranuar kapital të ri. Viti 2021 ka rezultuar me një rritje signifikante të kapitalit për FKGK-në. Qeveria e Republikës së Kosovës ka kontribuar në rritjen e kapitalit në shumë 21,410,000 euro dhe KfW ka dhuruar shumën prej 11,500,000 euro. Gjatë vitit 2021, KfW ka dhuruar shtesë dhe 5,600,000 euro.

	Qeveria e Republikës së Kosovës	USAID	KFW	Fitimi i akumuluar	Gjithsej
<b>Kapitali 2016</b>	2,000,000 €	5,345,141 €	-	(3,149.00)	7,341,992 €
<b>Kapitali 2017</b>	1,000,000 €	445,780 €	7,000,000 €	179,017.00 €	8,624,797 €
<b>Kapitali 2018</b>	-	-	-	320,012 €	320,012 €
<b>Kapitali 2019</b>	-	-	-	484,334 €	484,334 €
<b>Kapitali 2020</b>	21,410,000 €	-	11,500,000 €	66,312 €	32,976,312 €
<b>Kapitali 2021</b>	-	-	5,600,000 €	(430,202)	5,169,798 €
<b>Gjithsej</b>	24,410,000 €	5,790,921 €	24,100,000 €	616,324 €	54,917,245 €
<b>%</b>	44%	10%	44%	2%	100%


Kapitalizimi i institucionit është i një rëndësie të veçantë për të mundësuar rritjen e potencialit garantues të FKGK-së dhe njëkohësisht për të transmetuar siguri në tregun financiar. FKGK përdor një politikë të levërimit të kapitalit të saj që përcaktohet varësisht nga indikacionet e riskut në treg/sector, duke u siguruar që FKGK-ja të ketë kapital të mjaftueshëm për ta kryer aktivitetin e

saj dhe për t'i absorbuar humbjet e mundshme. Rritja e potencialit garantues, ndikon në rritjen e kreditimit nga ana e institucioneve financiare duke u ofruar komfort për të hulumtuar treg të ri kreditor dhe në veçanti për të mbështetur sektorët më të pa favorizuar e që janë me rëndësi të madhe për zhvillimin e sektorit privat dhe në tërësi ekonomisë së Kosovës.



#### DEPOZITAT ME AFAT SIPAS MATURITETIT

FKGK investon një pjesë të kapitalit të vet në institucionet partnere të FKGK-së, siç edhe specifikohet në ligj. FKGK e reflekton besimin në institucionet partnere, duke lënë në menaxhim të tyre mjetet e investuara. Gjatë planifikimit për investime, FKGK kujdeset që të ofrojë likuiditet në tregun financiarë dhe rrjedhimisht një ndikim në rritjen e kreditimit nga ana e institucioneve financiare. FKGK gjithashtu optimizon normat e kthimit nga investimet, gjithmonë duke u kujdesur që të ruajë stabilitetin në treg, gjë që ka vazhduar edhe gjatë një situatë jostabile siç ishte gjatë vitit 2020, e ndjekur pjesërisht dhe përgjatë vitit 2021.



#### LETROT ME VLERË SIPAS MATURITETIT

Gjatë vitit 2021, FKGK ka investuar 37,042,829 euro në depozitat me afat me institucionet partnere financiare të FKGK, me maturitet njëvjeçar, dyvjeçar dhe trevjeçar, duke vazhduar kështu bashkëpunimin shumëvjeçar në këtë drejtim. Në vitin 2021, FKGK ka investuar dhe në Letra me Vlerë të Qeverisë së Kosovës në vlerë prej 14,650,000 euro. Të ardhurat nga investimet konsolidohen në Pasqyrën e të Ardhurave, ndërsa fitimi vjetor rriinvestohet apo mbahet në FKGK, duke e rritur kapitalin, dhe nuk shpërndahet jashtë FKGK-së në asnjë formë apo mënyrë, duke i përfshirë edhe dividendët.

## SISTEMI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

Viti 2021 për pjesën e menaxhimit mjedisor dhe social ka qenë shumë i frytshëm, duke qenë pjesë integrale e politikave dhe aktiviteve, si dhe kritereve të përcaktuara lidhur me kreditë e garantuara e që kanë të bëjnë me pjesën shumë komplekse të menaxhimit mjedisor. FKGK-ja mban përgjegjësi të plotë për mjedisin dhe shoqërinë dhe si e tillë kujdeset që të shmangur dhe zvogëluar ndikimin negativ në mjedis nga investimet e mundësuar nga skema garantuese. Në mënyrë që të kontribuojë me përgjegjësi në zhvillimin ekonomik, FKGK-ja ka filluar me implementim të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor e Social. Qëllimi i SMMS-së është të sigurojë që projektet e financuara (planet e investimeve të kredive të kualifikuara) të identifikojnë dhe adresojnë masat për të shmangur dhe minimizuar ndikimet mjedisore dhe sociale sipas legjislacionit përkatës të Kosovës, kërkesave të Bankës Botërore dhe IFC-së. FKGK-ja implementon dy standarde në vijim:

**Standardin e performancës 1:** Vlerësimi, menaxhimi i rreziqeve mjedisore e sociale dhe ndikimet;  
**Standardi i performancës 2:** Puna dhe kushtet e punës.


Në këtë drejtim, FKGK-ja është e përkushtuar në identifikimin dhe adresimin e të gjitha rreziqeve mjedisore dhe sociale që lidhen me aktivitetet e veta garantuese. Përgjatë gjithë vitit, FKGK-ja ka mbajtur trajnime me IRF-të rreth SMMS-së ku janë informuar zyrtarët e bankave se si duhet të vlerësohet dhe menaxhohet risku mjedisor e social nga aktivitetet e tyre financiare. Ky proces u ka ndihmuar IRF-ve që të implementojnë sistemin e menaxhimit mjedisor dhe social, i cili ka bërë që IRF-të të jenë më të vetëdijshme gjatë procesit të financimit të bizneseve, gjithnjë duke konsideruar ruajtjen e ambientit. Kjo ka ndikuar që edhe ndërmarrjet (NMVM-të) të jenë më të vetëdijshme dhe më të kujdesshme gjatë veprimtarive të tyre. Gjatë vitit 2021, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ka arritur t'i trajnojë mbi 500 zyrtarë të IRF-ve lidhur

me SMMS-në. Gjatë këtyre trajnimeve, paralelisht, u është prezantuar edhe \*Manuali për kategorizim mjedisor dhe social, në të cilin përmes shembujve përshkruhen raste të ndryshme që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me ndikim mjedisor dhe social. Janë kryer shumë vizita nëpër biznese që kanë kredi të garantuar me rrezik të lartë mjedisor, në të cilat është vlerësuar nëse ato aplikojnë masat e caktuara në mënyrë që të shmangen ndikimet në mjedis dhe në shoqëri. Gjatë vitit 2021, në portfolion e FKGK-së, sektori me pjesëmarrjen më të madhe i kategorizuar me risk të lartë, ka qenë prodhimtaria me 306,148 €.

### SFIDAT:

Në implementim të SMMS-së me IRF-të, FKGK-ja ka hasur në sfida dhe vështirësi të ndryshme. Këto vështirësi janë paraqitur kryesisht gjatë analizës së rasteve të IRF-ve ku qëllimi kryesor ishte ndërtimi i objektit për veprimtari afariste në zona të mbrojtura me ligj të veçantë. Një tjetër sfidë e paraqitur kishte të bënte me rastet ku kërkohej të garantoheshin për ndërtime, por që nuk ishin të pajisura me leje ndërtimore. Duke marrë parasysh këto raste, FKGK-ja u angazhua që të mos bjerë ndesh me parimet dhe politikat mjedisore që rastet e tilla të mos pranohen nën garancion. Në vitin 2021, FKGK-ja vazhdoi me implementim të politikës së menaxhimit mjedisor dhe social sipas kërkesës së donatorëve duke u bazuar në standardet e IFC. Objektivi i PMMS-së është të plotësojë mandatin institucional me përgjegjësi të plotë ndaj mjedisit dhe shoqërisë dhe të sigurojë që IRF-të të kenë mbështetjen e duhur për të zvogëluar ndikimin negativ mjedisor të operacioneve të tyre. Për të realizuar në mënyrë të plotë SMMS-në, eksperti mjedisor është angazhuar në përditësimin e PMMS-së, si dhe në ndërtimin e një procesi të monitorimit dhe të raportimit. FKGK-ja do të vazhdojë të mbështesë dhe monitorojë IRF-të edhe në vitet në vijim, derisa të vlerësojmë që IRF-të janë të gatshme të vazhdojnë me këto procedura në mënyrë të pavarur.

### SHPËRNDARJA E PORTFOLIT NË SEKTOR SIPAS RISKUT MJEDISOR



# VEÇORIA E VITIT 2021

## PAKOJA E RIMËKËMBJES EKONOMIKE

Si në çdo vend në botë ashtu edhe në vendin tonë pandemia COVID-19 shkaktoi ndikim negativ në ekonominë e vendit duke ndikuar në rënie të likuiditetit të Ndërmarrjeve Mikro të Vogla dhe të Mesme (NMVM), pothuajse në të gjithë sektorët ekonomik, pa përjashtim. Natyrisht, kjo së pari ka prekur aktivitetet të cilat për shkak të pandemisë janë detyruar të punojnë me kapacitet të zvogëluar apo të mbyllën në tërësi.

Si përgjigje ndaj situatës pandemike nga COVID-19 e në mënyrë që të përballëshim me këtë situatë të pazakontë, Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2020, ndërmori një sërë veprimesh të koordinuara, një ndër të cilat ishte edhe disejtimi i Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike.


Pako e Rimëkëmbjes Ekonomike si një reagim i shpejtë dhe i duhur i Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID 19, do të mundësonte adaptimin e skemës garantuese të FKGK-së me qëllim të lehtësimit të qasjes në financa për sektorët e caktuar të ekonomisë, me theks të veçantë për segmentet e tregut që do të mund të ndikoheshin më shumë nga kriza e pandemisë. Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVID 19, në mesin e objektivave tjera, kishte për qëllim të krijonte bazën ligjore për modifikimin e skemës garantuese të FKGK-së, në mënyrë që të luftohej ngërçi kreditor që potencialisht do të mund të përkeqësonte edhe më shumë efektet negative nga kriza ekonomike e shkaktuar nga pandemia. Ligji i rimëkëmbjes ekonomike parashihte që t'i mundësonte FKGK-së ofrimin e mbulueshmërisë së kredive për NMVM-të me garancion deri në 80%, lejimin e garancisë kreditore për fermerët dhe subvencionimin e tarifës së garancisë. Ky adaptim ishte një ndër masat më të rëndësishme të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike.

Në relacion me këtë, FKGK në fillim të vitit 2021 implementoi dritaret garantuese në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike (PRE) :

- Dritarja për Prodhim
- Dritarja për Shërbime
- Dritarja për Gratë në Biznes
- Dritarja për Start up
- Dritarja për Bujqësi, dhe
- Dritarja për Tregti

Këto dritare do të adresonin nevojat për likuiditet dhe investime për sektorët dhe segmentet strategjike të vendit tonë. Zbatimi i kësaj iniciative të përbashkët u bë i mundur me kapitalin e siguruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Programit të Bankës Botërore për Fuqizimin e Sektorit Financiar në vlerë prej 21.4 milionë euro, si dhe nga Qeveria Gjermane përmes Bankës Zhvillimore – KfW në vlerë prej 5 milionë euro.


Përpos kontributit në kapital, Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK) përmes Ministrisë së Financave (MF) zgjeroni kontributin tutje, duke nënshkruar me FKGK-në marrëveshjen e bashkëpunimit për subvencionimin e tarifës së garancisë. Përmes kësaj marrëveshjeje, MF-ja u zotua të mbulojë tarifën e garancisë në vlerë totale deri në 5 milionë euro. Me kapitalizimin e institucionit, FKGK alokoi limite garantuese për tetë Institucione të Regjistruara Financiare me çrast u mundësua një kredidhënie në vlerë prej 105.55 milionë euro, shpërndarë në 2,015 kredi për 1,720 NMVM të angazhuara në sektorët e Prodhimit, Shërbimeve, Bujqësisë, Tregtisë si dhe segmentet si Gratë në Biznes dhe Startup-ët edhe përkundër rritjes së perceptimit të riskut në treg dhe pa-parashikueshmërisë së rrjedhës së ngjarjeve të shkaktuara nga gjendja që solli pandemia.



Përmes Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike (Dritaret e PRE-së) përveç që të zvogëlohej ndikimi negativ i krizës pandemike në sektorin e NMVM-ve, si dhe të lehtësimi i qasjes në financa për NMVM-të gjatë dhe pas krizës pandemike, po ashtu pritej që qasja në financa të bëhej me standarde më të relaksuara të kredihënies. Monitorimi i këtyre treguesve rezultoi se në saje të aktivitetit të FKGK-së në përgjithësi është rritur qasja në financa dhe janë relaksuar standardet e huadhënies, duke u siguruar një shtueshmëri financiare si në:

- Rritje të nivelit të kreditimit për përfituesit final;
- Rritje të mesatares së kredisë;
- Rritje të maturitetit të kredisë;
- Ulje të kërkesës për kolateral;

Norma më të mira interesi për kreditë e garantuara në kuadër të Dritareve të PRE-së në krahasim me kategoritë e njejta të garantuara në Dritaren e Rregullt dhe Dritaren Agro.



Implementimi i Dritareve në kuadër të PRE-së filloi në fillim të vitit 2021 dhe përfundoi më 31 dhjetor 2021, ashtu siç parashihej në Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID 19. Duke vlerësuar efektet pozitive që kanë pasur ndryshimet e bëra në Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVID 19, në funksion të mbështetjes së NMVM-ve dhe fermerëve të regjistruar nga ministria përgjegjëse për bujqësi në financimin e projekteve të tyre, dhe qëllim të krijimit të bazës ligjore për përmbushjen e objektivave strategjike të FKGK-së në mbështetjen së zhvillimit të ndërmarrësisë, sektorit

të agros dhe sektorët tjerë të ekonomisë së Kosovës dhe kjo si rrjedhojë me impakt në rritjen e prodhimit vendor dhe shërbimeve me vlerë të shtuar, në krijimin e vende të reja të punës dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik në përgjithësi, FKGK gjatë vitit 2021 i ka dërguar me shkrim Qeverisë rekomandimet për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Themelimin e FKGK-së, të cilat në rast miratimit nga Qeveria të njëjtat do të jenë objekt shqyrtimi dhe miratimi në Kuvendin e Republikës së Kosovës.



PJESA V





# AKTIVITETET GJATË VITIT 2021



## FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE FILLOI ZBATIMIN E DRITAREVE GARANTUESE NË KUADËR TË PAKOS SË RIMËKËMBJES EKONOMIKE

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK-ja) nënshkroi marrëveshjet e garancisë me Institucionet Partnere Financiare për dritaret garantuese në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike. Me nënshkrimin e marrëveshjeve të garancisë me institucionet financiare partnere, filluan zbatimin e dritareve garantuese të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike (PRE). Dritaret garantuese në kuadër të PRE-së janë linja të reja garantuese që kanë për qëllim mbështetjen e Ndërmarrjeve Mikro të Vogla dhe të Mesme (NMVM) përmes garantimit të kredive.



Kjo Pako, do të rris mbulueshmërinë me garancion kreditor deri në 80% të vlerës së kredisë, duke i ofruar mundësi të përfshirjes edhe fermerëve me Numër Identifikues të Fermerit (NIF). Dritaret garantuese në kuadër të PRE-së kishin në fokus mbështetjen e kreditimit në sektorët e prodhimit, agrobiznesit, shërbimeve, tregtisë, me fokus të veçantë për gratë në biznes dhe bizneset e reja (start-up). Dritaret garantuese brenda kësaj Pakoje mbështesin qasjen në financa për NMVM-të në vlerë deri në € 202 mio për një periudhë një vjeçare. Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike përfundoi më 31 dhjetor 2021.

### SHKURT 2021

## PËRFAQËSUES TË FKGK-SË PRESIN NË TAKIM GUVERNATORIN MEHMETI DHE PËRFAQËSUESIT E BQK-SË

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të FKGK-së z. Gjonbalaj dhe Drejtori Menaxhues i FKGK-së z. Berisha pritën në vizitë Guvernatorin e BQK-së z. Mehmeti, zv. Guvernatorin z. Havolli, si dhe Shefin e Kabinetit të Guvernatorit z. Miftari. Gjatë takimit, përfaqësues të të dy institucioneve diskutuan rreth zhvillimeve në përgjithësi si dhe rreth mundësive të reja lidhur me lehtësimin e qasjes në financa për bizneset në mënyrë që të përballojnë më lehtë barrën financiare gjatë procesit të rimëkëmbjes dhe zhvillimit të tyre.





MAJ 2021

## FKGK NËNŠKRUAN MARRËVESHJE ME DY INSTITUCIONE MIKROFINANCIARE

Fondit Kosovar për Garanci Kreditore nënshkruan marrëveshjen e garancisë për garantimin e kredive bujqësore brenda Dritares Agro me dy Institucionet Mikro Financiare më të mëdha për sa i përket vëllimit të kredive aktive – KEP Trust dhe FINCA Kosovë.


Kjo ngjarje shënon një moment kyç për FKGK-në dhe për sektorin mikrofinanciar duke ofruar garanci për kredi bujqësore për fermerët dhe agrobizneset vendore.



QERSHOR 2021

## BANKA EVROPIANE PËR INVESTIME DHE MINISTRIA E FINANCEVE NËNŠKRUAJNË MARRËVESHJEN FINANCIARE PËR KOSOVËN

Banka Evropiane për Investime (EIB) dhe Ministria e Financave nënshkruajnë Marrëveshjen Financiare për Kosovën për të mbështetur qasjen në financa për NMVM-të. Kredia në vlerë prej 40 milionë eurosh e siguruar nga EIB për Kosovën i dedikohet qasjes në financa për NMVM-të e prekura nga COVID-19. Ky projekt do të zbatohet përmes Fondit Kosovar për Garanci Kreditore për të adresuar një nga brengat kryesore të sektorit privat, që është vazhdimësia e aktivitetit përmes realizimit të investimeve në fazën e rimëkëmbjes. FKGK me entuziazëm ka pritur këtë ngjarje duke siguruar që me profesionalizmin më të lartë përmes skemës së saj garantuese do të vazhdojë përpjekjet për luftimin e efekteve negative të shkaktuara nga pandemia COVID-19.



SHKURT 2021

## FKGK MERR PJESË NË FORUMIN VIRTUAL TË ORGANIZUAR NGA AMCHAM

Drejtori Menaxhues i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, z. Besnik Berisha mori pjesë në forumin virtual të organizuar nga AmCham mbi mundësitë për lehtësimin e qasjes në financa në fazën e rikuperimit. Në këtë panel z. Berisha njoftoi pjesëmarrësit për veprimtarinë aktuale të FKGK-së, si dhe për masat që po ndërmerren nga FKGK-ja, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë, për të mbështetur NMVM-të duke ofruar lehtësim të qasjes në financa në fazën e rikuperimit.



MARS 2021

## FKGK PJESË E TAKIMIT ME PËRFAQËSUES TË BIZNESEVE SI DHE TË BANKAVE KOMERCIALE ORGANIZUAR NGA BQK

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës organizon takime me përfaqësues të bizneseve dhe të bankave komerciale. Në këto takime, drejtuesit e FKGK-së informuan pjesëmarrësit lidhur me zhvillimet e Institucionit në përgjithësi, masat e ndërmarra lidhur me zbatimin e Dritareve në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes, si dhe planet për zhvillimet e ardhshme lidhur me lehtësimin e qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë, rritjen e punësimit dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit tonë.



PRILL 2021

## FKGK PJESË E NGJARJES “MEKANIZMAT E FINANCIMIT TË EKSPORTEVE”

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ishte pjesë e ngjarjes “Mekanizmat e Financimit të Eksporteve” organizuar nga projekti USAID Compete Activity. Drejtori Menaxhues i FKGK-së, z. Besnik Berisha ishte pjesë e panelit virtual “Mekanizmat e Financimit të Eksportit”, në të cilin njoftoi pjesëmarrësit për të arriturat e Fondit përgjatë viteve, veprimtarinë aktuale të FKGK-së, si dhe cila është strategjia e institucionit për të adresuar çështjen për të cilën u bisedua në këtë ngjarje. Me këtë rast, z. Berisha njoftoi pjesëmarrësit se në kuadër të PRE-së, FKGK ka dizajnuar dritare që adreson sektorin e prodhimit, që potencialisht është edhe sektori që ndihmon në rritjen e eksportit.



PRILL 2021

## FKGK FESTON 5 VJETORIN E LANSIMIT TË TIJ

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore shënoi pesë vjetorin e themelimit të tij si një institucion i pavarur. Gjatë këtyre 5 viteve, Fondi ka punuar pa ndalur, duke qenë proaktiv ndaj nevojave të sektorit, duke i përmirësuar në vazhdimësi proceset, kriteret kualifikuese, duke i avancuar produktet e garancisë dhe duke dhënë më të mirën e mundur për të qenë një institucion shembull dhe kontribuues në ekonominë e vendit. Për nder të 5 vjetorit të themelimit, FKGK ka dhuruar për kryeqytetin dhjetë drunj bliri përmes fushatës së Komunës së Prishtinës “Bëhu mik i Prishtinës”, që janë mbjellë në Kompleksin Memorial.



MAJ 2021


## TAKIM ME PËRFAQËSUES TË RRJETIT TË SHITËSVE ME PAKICË

Përfaqësues të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore takohen me përfaqësues të Rrjetit të Shitësve me Pakicë, ku u diskutua për sfidat e shitësve me pakicë dhe garancitë kreditore të FKGK-së si një mundësi e qasjes më të lehtë në financa.



## TRAJNIMI PËR NGRITJE TË NJOHURIVE LIDHUR ME SISTEMIT PËR MENAXHIMIN MJEDISOR E SOCIAL

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore përmes Sistemit për Menaxhimin Mjedisor e Social (SMMS) përpqet të sigurojë që kreditë e garantuara të kenë ndikim minimal në mjedis dhe shoqëri. Për të implementuar këtë përpjekje sa më mirë, përpos mbështetjes së dhënë Institucioneve Partnere Financiare (IPF) për implementimin e SMMS-së, po ashtu ka mbajtur trajnime me personelin e IPF-ve rreth elementeve kryesore të SMMS-së si dhe procesit të kategorizimit, analizës dhe të zbutjes të rrezikut mjedisor dhe social. Numri i të trajnuarve gjatë këtij gjysmë vjetori ka arritur në 436.



## SESIONE ORIENTUESE PËR SKEMËN E GARANCISË TË FKGK-SË

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ka mbajtur sesione orientuese me stafin e FINCA Kosovo dhe stafin e KEP Trust. Roli i FKGK-së dhe Dritares Agro në veçanti ishin në fokus të sesionit, duke ju ofruar mundësinë e një përfshirjeje sa më të madhe për financimin e fermerëve vendorë. Në këtë mënyrë, FKGK ofron gjithëpërfshirje të klientëve të cilët zakonisht financohen nga këto Institucione Mikrofinanciare. Ndër të tjera, stafi u trajnuar edhe për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social.



## FKGK PJESË E PANELIT NË WEBINAR "FINANCAT E QËNDRUESHME PËR INSTITUCIONET FINANCIARE"

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ishte pjesë e panelit në webinar-in "Financat e Qëndrueshme për Institucionet Financiare / Sustainable Finance for Financial Institutions" të organizuar nga International Finance Corporation (IFC) dhe Recura sh.a. në bashkëpunim me Sekretariati Zviceran për Çështjet Ekonomike SECO. Në këtë panel Menaxherja e Lartë e Garancioneve në Fondin Kosovar për Garanci Kreditore znj. Nora Arifi, njoftoi pjesëmarrësit për veprimtarinë aktuale të FKGK-së lidhur me Sistemin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS), për mbështetjen e dhënë për implementimin e SMMS edhe nga ana e Institucioneve Financiare të Regjistruara në FKGK, si dhe për masat që po ndërmerren nga FKGK-ja në mënyrë që të sigurojë që kreditë e garantuara të kanë një ndikim pozitiv klimatik duke i'u nënshtruar kontrollit mjedisor dhe kujdesit të duhur në përputhje me kërkesat e SMMS.



## FKGK FILLON ME ZBATIMIN E PLOTË TË MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore tashmë ka filluar me zbatimin e plotë të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor e Social (SMMS). Në përputhje me përpjekjet tona institucionale për të kontribuar në zhvillimin ekonomik, me përgjegjësi të plotë për mjedisin dhe shoqërinë, FKGK së bashku me IRF-të do të përdorin standardet më të larta mjedisore dhe sociale për të zbutur ndikimet e pafavorshme mjedisore të projekteve të financuara.

## MBAHET FORUMI I SOLARËVE

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ishte pjesëmarrëse në Forumin e Solarëve që u organizua nga Ministria e Ekonomisë dhe USAID. Qëllimi i këtij Forumi ishte të promovojë dhe paraqitjes së tregjeve të vetë konsumit dhe projekteve të reja solare në Kosovë. Në këtë ngjarje u lansua web faqja si dhe u diskutua draft koncept dokumenti që flet për Ligjin për Energji të Ripërtrishme.

## FKGK LANSON DRITARËN START-UP NË KUADËR TË DRITAREVE TË PAKOS SË RIMËKËMBJES EKONOMIKE

FKGK lanson Dritarën Start-up në kuadër të dritareve të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike. Dritarja Start-up është një linjë e re garantuese që do të operojë në kuadër të FKGK-së dhe që ka për qëllim mbështetjen e Ndërmarrjeve të reja përmes garantimit të kredive. Kjo dritare, parasheh të rritë mbulueshmërinë me garancion kreditor deri në 80% të vlerës së kredisë, dhe njëkohësisht do të adresojë nevojat e këtij segmenti të caktuar të tregut. Nga kjo dritare pritet të ndihmohet qasja në financa për ndërmarrjet e reja të ndikuara nga kriza. Dritarja Start-up pritet të mbështesë qasjen në financa për ndërmarrjet e reja në vlerë deri në 2 MM € për periudhën kohore deri më 31 dhjetor 2021. Kjo dritare në këtë kohë pandemie, do të ketë vlerë të shtuar si për përfituesit e fundit (Bizneset Start-up) të cilëve do të ju mundësohet qasje në financa me kushte më të mira të kredidhënies, ashtu edhe për Institucionet Partnere Financiare (IPF) të cilat do të kenë mundësi të ndajnë një pjesë të madhe të riskut kreditor me FKGK-në. Një dritare e tillë është vlerësuar nga Institucionet Financiare të cilat e shohin si të domosdoshëm mbështetjen për bizneset e reja të cilat kanë qasje më të limituar në financa. Kjo ngjarje shënon një moment të radhës për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore, në rrugën e realizimit të objektivave institucionale, para se gjithash, lehtësimin e qasjes në financa për ndërmarrjet e reja.



## NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E GARANCISË ME KREDITIMIN RURAL TË KOSOVËS

Në ambientet e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), u nënshkrua Marrëveshja e Garancisë me Kreditimin Rural të Kosovës (KRK).

Kjo marrëveshje u nënshkrua për garantimin e kredive bujqësore brenda Dritaresh Agro të FKGK-së. Kjo ngjarje shënon më tutje zgjerimin e marrëveshjeve që FKGK realizon gjatë këtij viti me Institucionet Mikrofinanciare duke ofruar garanci për kredi bujqësore për fermerët dhe agrobizneset vendore. Deri më tani janë garantuar rreth 27 milion euro – kredi bujqësore dhe janë rreth 9 milion euro garanci aktive në këtë sektor. Kapitali i përgjithshëm i Dritaresh Agro është në vlerë totale prej 11.5 milion euro që është financuar plotësisht nga Qeveria Gjermane, përmes Bankës Gjermane për Zhvillim – KfW.



SHTATOR 2021

## TAKIME VIRTUALE ME GRA NË BIZNES - ORGANIZUAR NGA RIINVEST


FKGK organizoi takime virtuale me gra të përfshira në biznes, me ç'rast u prezantua puna e Fondit dhe Skemave Garantuese.



SHTATOR 2021

## SESIONE ORIENTUESE PËR DRITAREN START-UP


Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mbajti sesione orientuese për Dritaren Startup pas marrëveshjeve të nënshkruara me IRF-të. Në pesë sesione të organizuara në të cilat morën pjesë rreth 255 i IRF-ve u diskutua rolin e skemave garantuese, dritaret në kuadër të PRE-së me theks të veçantë në Dritaren Startup të lansuar në gusht të këtij viti.



TETOR 2021

## TAKIME VIRTUALE ME START-UP, NË BASHKËPUNIM ME GIZ

U mbajt takimi virtual në bashkëpunim me GIZ, me ç'rast u prezantua skema garantuese e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore si dhe u shpalosën informatat rreth skemave garantuese dritares StartUp që është e dizajnuar për këtë kategori.



TETOR 2021

## TRAJNIME PËR STAFIN E KRK-SË - DRITARJA AGRO – PËRDORIMI I AGROSOFT-IT

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mbajti trajnime rreth përdorimit të platformës AgroSoft, me stafin e Kreditimi Rural i Kosovës ( KRK) pasi u nënshkrua marrëveshja me ta. Ky trajnim, është pako e vazhdueshme që FKGK mbanë për IRF-të, ku përmes kësaj platforme, FKGK-ja ndihmon qasje më të lehtë në financa për fermerë dhe agrobiznese vendore. Në këtë trajnim u mbajtën në tri grupe dhe gjithsej të trajnuar janë 61 staf të KRK-së.



## PUNËTORIA ME GAZETARË GAZETARIA EKONOMIKE DHE FINANCIARE 2021 "TË BËJMË LAJME NGA NUMRAT"



Fondi Kosovar për Garanci Kreditore së bashku me Shoqatën e Bankave të Kosovës, organizuan punëtorinë dy ditore me temën: **"Gazetaria ekonomike dhe financiare 2021– Të bëjmë lajme nga numrat"**.

Në këtë punëtori ishin prezent gazetarë, të shumë mediave audiovizuale si dhe online. Në këtë punëtori u diskutua për: sektorin bankar, rëndësinë e skemave garantuese dhe tema për ekonominë në përgjithësi. Përfaqësues të institucioneve të Kosovës BQK, ATK; Thesari i Kosovës, MINT; donatorë - KfW si dhe përfaqësues të biznesit ishin pjesë e paneleve dhe prezantuan për temat:

- Efekti i pandemisë Covid19 në sistemin bankar dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë;
- Bashkëpunimi ndërinstytucional me sistemin financiar për të ruajtur stabilitetin dhe nxitur zhvillimin ekonomik;
- Masat e qeverisë për rimëkëmbje ekonomike.

Kjo punëtori solli një atmosferë bashkëpunuese dhe ishte mundësi e mire për të gjithë pjesëmarrësit të diskutojnë së bashku rreth sektorit bankar & ekonomisë.



TETOR 2021

## TRAJNIME PËR KATEGORIZIMIN MJEDISOR – POLITIKAT E MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mbajti trajnime rreth zbatimit të SMMS për IRF-të. Këto trajnime janë optimizuar bazuar në kapacitetet egzistuese të Institucioneve të regjistruara financiar. Janë mbajtur tri seanca me nga 20 pjesëmarrës, staf i KRK-së. Numri i stafit të trajnuar arriti shifrën 61. FKGK në vazhdimësi mbanë trajnime për SMMS varësisht nga vlerësimi dhe kërkesat e IFR-ve.



NËNTOR 2021

## PJESËMARRJA E STAFIT TË FKGK-SË NË PANELE DISKUTIMESH "JAVA E NDËRRMARRËSISË GLOBALE"

TEB organizoi diskutimin me temën "Qasja në Financa për Gratë Ndërmarrëse" Përfaqësues shtetëror, të institucioneve ndërkombëtare e vendore bashkë me përfaqësues të Bankës TEB kanë diskutuar për financimin e aktiviteteve afariste të Grave ndërmarrëse duke shënuar Javën Ndërkombëtare të Ndërmarrësisë (Global Entrepreneurship Week).



NËNTOR 2021

## QASJA NË FINANCA PËR START-UP

Me qëllim të shënimit të Javës Globale të Ndërmarrësisë (GEW), VentureUp organizoi takim me StartUP: Takimi ka dy pika kryesore të diskutimit:

1) sfidat e ndërmarrësve në Kosovë, dhe 2) mundësitë për qasje në financa për startupet në Kosovë. Takimi organizohet së bashku me Jakova Innovation Centre (JIC) në bashkëpunim me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore, EBRD, dhe disa banka që do të shpalosin ofertat e tyre financiare specifike për Startup-ët.

## GJERMANIA MBËSHTET FONDIN KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE (FKGK)

Nënshkruhet marrëveshja mes Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) dhe KfW – Banka Gjermane për Zhvillim. 6 milion euro shtesë për FKGK ku ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të përfitojnë nga investimet e gjelbra. Hapjen e bëri z. Rinor Gjonbalaj – Kryesues i Bordit të FKGK-së. Këtë marrëveshje e nënshkruan nga Dr. Klaus-Martin Müller, Drejtor për Europën Juglindore dhe Turqi nga KfW- Banka Gjermane për Zhvillim dhe z. Besnik Berisha – Drejtor Menaxhues i Fondit për Garanci Kreditore.

Në shenjë falenderimi për përkrahjen e vazhdueshme nga KfW – Banka Zhvillimore Gjermane, gjatë ceremonisë ju nda edhe një plaketë mirënjohjeje nga Drejtori Menaxhues z. Besnik Berisha. Në ceremoninë e nënshkrimit ishin të pranishëm z. Hekuran Murati – Ministër i Financave në Republikën e Kosovës; z. Jörn Rohde – Ambasador i Gjermanisë në Republikën e Kosovës; Fehmi Mehmeti Guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës; Dr. Klaus-Martin Müller, Drejtor për Europën Juglindore dhe Turqi nga Banka Gjermane për Zhvillim – KfW; të cilët mbajtën nga një fjalim rasti në këtë ceremoni.



## FKGK PJESË E PANELIT ORGANIZUAR NGA PROGRAMI I USAID - KOSOVO COMPETE ACTIVITY

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ishte pjesë e panelit në ngjarjen "Partneriteti Ndërmjet Shitësve të Pajisjeve me Lizing dhe Institucioneve Financiare të Lizingut në Industrinë e Përpunimit të Drurit" organizuar nga Programi i USAID-it Kosovo Compete Activity në bashkëpunim me Shoqatën e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPDK) dhe Raiffeisen Leasing Kosova (RLKO). Në këtë panel Menaxherja e Lartë e Garancioneve në Fondin Kosovar për Garanci Kreditore znj. Nora Arifi, njoftoi pjesëmarrësit se në kuadër të PRE-së, FKGK ka dizajnuar dritare që adresojnë sektorin e prodhimit, si dhe masat që do të ndërmerr në vazhdim në mënyrë që të mbështes këtë sektor që ndihmon zhvillimin ekonomik dhe rritjen e eksportit.





## FKGK NË MEDIA

MARS 2021

Intervistë me Menaxheren e Lartë të Riskut të FKGK-së znj. Nora Arifi, në programin e mëngjesit në KTV. U diskutua për skemat garantuese në përgjithësi si dhe rolin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.



SHTATOR 2021

Intervistë me z. Kastriot Këpuska, Agro Ekspert, në emisionin "7 ditë me Panxhën" në Klan Kosova. Tema e diskutimit ishte "Garancionet dhe financimi i bazuar në kontrata". U diskutua lidhur me financimin e sektorit të bujqësisë dhe rolin që FKGK në financimin e shumë sektorëve të ekonomisë me theks të veçantë gjatë pandemisë.



SHTATOR 2021

Intervistë me Menaxherin e lartë të Riskut të FKGK-së z. Alban Krasniqi, në programin e mëngjesit në RTK - "Mirëmengjesi Kosovë" ku u diskutua lidhur me rolin e FKGK-së në kuadër të PRE-së, skemat garantuese si dhe për dritaren StartUP.



SHTATOR 2021

Intervistë me Menaxheren e Lartë të Riskut të FKGK-së z. Nora Arifi në programin e mëngjesit në ATV me ç'rast përveç që u diskutua për FKGK-në dhe skemat garantuese në përgjithësi, në këtë emision u promovua dritarja Start-Up, u fol për kushtet dhe karakteristikat e Dritaresh Start-UP.



TETOR 2021

Intervista e Drejtorit Menaxhues në EkonomiaOnline - FKGK me 40 milionë € shtesë, përparësi bizneset që nuk i sjellin dëm ambientit. Drejtori Ekzekutiv i FKGK-së, Besnik Berisha, tha për Ekonomia Online se këto mjete do të ndahen për bizneset që do të kalojnë procesin e vlerësimit nga bankat financiare në Kosovë. "Pjesa e 40 milionëshit që parashihet të dhurohet nga Qeveria e Kosovës nga Kredia prej Bankës Evropiane të Investimeve do të jetë për qëllim të rritjes së kapitalit të FKGK-së, kapital ky që do të shërbej për mbështetjen e operacioneve bazë të Fondit e që është ofrimi i garancioneve kreditore për bankat partnere në sektorin financiar të Kosovës".



NËNTOR 2021

Paraqitja në programin e mëngjesit "SOT" në Kohavision - 40 Milion Euro ndihmë NMVM-ve, flet Drejtori i FKGK-së - z. Besnik Berisha. Nëntor 2021 - Paraqitje në lajmet e orës 15:00 në RTK, ku u fol për aprovimin e kapitalit shtesë në shumë 40 milion Euro. Kapital shtesë nga EIB për FKGK-në.



### “THE WHITE TREE” – Një start up në lagjen Pejton

“The White Tree” - është një restorant në Prishtinë, i themeluar në vitin 2020 nga tre shokë/kolegë të mëhershëm.


“Të themelosh një biznes që prej fillimit është sfidë, ndaj përpos aspektit financiar futja në një aktivitet të ri është më e lehtë kur nuk i hyn i vetëm, por së bashku me partnerë. Ne filluam biznesin në vitin 2020 mu në fillim të pandemisë. Ishte iniciativë e përbashket e partnerëve për të sjellë një koncept të ri, me një shërbim cilësor në lagjen ku ‘operojmë’, thekson z. Durim Xhiha, bashkë-pronar dhe drejtor i biznesit ‘White Tree’.

‘White Tree’ punëson 19 punëtorë, ndërsa aktualisht është në proces të zgjerimit edhe me 6 punëtorë shtesë. Fuqizimi i gruas është njëri nga synimet e themeluesve, ndaj është planifikuar që pjesëmarrja e grave, nga 40% sa është aktualisht, të rritet për të arritur në 60%.

“Investimet në biznes kryesisht u bënë nga kapitali i bashkëthemeluesve, por gjithsesi kishte nevojë për një injektim shtesë, për të përfunduar investimet në inventarin e restorantit. Këtë investim e arritëm me kredinë e garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore”, thekson z. Xhiha.

Përmes investimit të bërë, biznesi arriti të funksionalizojë hapësirën e restorantit, duke e bërë të gatshme për fillimin e aktivitetit.

Mbështetja e këtij investimi është bërë përmes kredisë së garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, së bashku me Programin COSME të Fondit European për Investime, të cilat janë duke mbështetur qasjen në financa për NMVM-të në fazat e ndryshme të ciklit, si gjatë krijimit, zgjerimit apo transferimit të biznesit.



### AGRIUM SHPK

Në një ditë të bukur shtatori, vizituam kompaninë AGRIUM FRUITS SHPK – që ndodhet në fshatin Lloshkobar në afërsi të qytetit të Ferizajit, aty takuam një ndërmarrës të veçantë, zotëriun Avdullah Isufi, i cili themeloi këtë biznes në vitet 2000, e tanimë punët kyçe ua ka besuar djemve të tij. Filloi me prodhimtari primare, pastaj gjithnjë duke e zgjeruar punën dhe aktivitetet që ndërlidhen me mbledhjen dhe konzervimin e frutave dhe perimeve të freskëta dhe cilësore nga fermerët dhe gjetjen e tregjeve, si dhe sigurimin e inputeve të ndryshme bujqësore.

Vitet 2010 – 2011 ishin vite vendimtare të rritjes dhe zgjerimit të biznesit të tij.

Në vitin 2016 përmes kredive, AGRIUM FRUITS SHPK kishte siguruar blerjen e frigoriferëve në mënyrë që të rritë kapacitetin e ngrirjes së frutave, farërave e rendimenteve të ndryshme.

Viti 2016 dhe pikërisht muaji shtator, lidhet edhe me muajin kur Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) është operacionalizuar ku ndër garancitë e para kreditore të lëshuara ishte për kompaninë AGRIUM FRUITS SHPK, mu për këtë investim.

“Me zgjerimin e vazhdueshëm të aktiviteteve ne kishim nevojë për investime në pajisje në mënyrë që aktiviteti ynë të mbështetet sa më mirë. Këtë investim e arritëm me kredinë që u garantua nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore krahas së cilës edhe kërkesa për kolateral ishte shumë më e ulët”, thekson z. Isufi.

